



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA E AUDITORIT PËRGJITHSHËM
KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA
OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS

2013

Prishtinë, prill 2014



FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

I nderuar Kryetar, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës



Ky është Raporti Vjetor i Performancës, i gjashti, të cilin ua kam dorëzuar.

Ky raport përqendrohet në mënyrën se si unë i kam shfrytëzuar burimet që më janë besuar. Përveç kësaj, ai përmbledh rezultatet që zyra ime ka arritur gjatë vitit 2013. Gjithashtu, raporti mundëson krahasimin me vitet e mëparshme buxhetore dhe tregon hapat që do të ndërmerren për të adresuar sfidat e hasura.

Raporti Vjetor i Performancës ofron një bazë që më bën mua llogaridhënës për ushtrimin e mandatit tim për vitin 2013. Në të njëjtën kohë raporti duhet të shërbejë si një kontribut në dialogun për buxhetin e vitit 2015.

Gjatë vitit buxhetor 2013 ne finalizuam sezonin e auditimit 2012/13 në gusht dhe filluam sezonin e auditimit 2013/14 në shtator. Rezultatet e arritura nxjerrin në pah se i kemi përdorur në mënyrë efektive parakushtet që Kuvendi na i ka dhënë dhe mbulimi i auditimit tanimë është më gjithëpërfshirës.

Sa i përket cilësisë së auditimit dhe ndikimit të punës sonë treguesit nxjerrin në pah trendin pozitiv me kalimin e viteve.

Kjo është si rrjedhojë e qasjes dhe fokusit të pavarur në punën tonë operative; shumica e stafit tonë është e përkushtuar në zhvillim të vazhdueshëm dhe ndryshim për të përmbushur nevojat, kërkesat, pritjet e reja; dhe partnerët dhe kolegët tanë ndërkombëtarë punojnë në kuadër të

kontekstit të veçorive dhe nevojave specifike të Kosovës.

Bashkëpunimi ynë konstruktiv me Kuvendin dhe bashkëpunimi vazhdimisht në rritje me ekzekutivin në fushën e Menaxhimit të Financave Publike janë po aq të rëndësishme. Dialogu i vazhdueshëm me të audituarit gjithashtu i kontribuon këtij progresi inkurajues.

Pavarësia dhe paanësia janë parakushte për një auditim të jashtëm publik që funksionon mirë. Një kornizë e re ligjore për Auditorin e Përgjithshëm është tashmë duke u zhvilluar përkundër disa vonesave në procesin e ligjërjes. Një nga prioritetet në vitet që do të vijjnë është garantimi që kjo kornizë të jetë në pajtim me standardet e auditimit në sektorin publik të pranuar ndërkombëtarisht dhe të implementohet siç duhet.

Fokusi jonë afat shkurtër, me këtë raport si bazë të tij, do të jetë nxitja e një kulture të orientuar kah rezultatet në zyrë. Ne përmbushim objektivat tona operative dhe administrative përmes punëtorëve profesional, etik, të motivuar në të gjitha nivelet, të aftë për të ndryshuar në mënyrë konstante sipas kërkesave dhe pritshmërive të reja.

Kjo reflektohet gjithashtu në marrëveshjet e arritura me partnerët tanë, të cilët do të na ndihmojnë për këtë gjatë viteve të ardhshme. Misioni ynë është që të bëhemi një institucion publik i auditimit të jashtëm, i cili i zbaton plotësisht dhe në mënyrë të qëndrueshme standardet e auditimit në sektorin publik të pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikën e mirë Evropiane.

Bashkëpunimi konstruktiv dhe një dialog i fortë për buxhetin me palët tona kryesore të interesit është kërkesë për arritjen e këtyre ambicieve.

Shpresoj që ky raport do të kontribuoj në këtë.

Prishtinë, 30 Prill 2014

Auditori i Përgjithshëm

TABELA E PËRMBAJTJES

FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM.....	3
TABELA E PËRMBAJTJES.....	4
1. PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS.....	6
2. TREGUESIT E REZULTATEVE.....	8
2.1 MBULIMI ME AUDITIM.....	8
2.2 CILËSIA E RAPORTEVE TONA.....	10
2.3 NDIKIMI.....	11
2.4 VLERËSIMI I JASHTËM DHE I BRENDSHËM.....	13
3. BURIMET.....	15
3.1 BURIMET NGA BUXHETI I KOSOVËS.....	15
3.2 MENAXHIMI I PASURISË FIKSE.....	18
3.3 BURIMET NJERËZORE.....	18
3.4 REKOMANDIMET NGA AUDITORËT E JASHTËM.....	21
4. BASHKËPUNIMI.....	22
4.1 PROJEKTET.....	23
4.2 PUNA NË RRJET.....	24
4.3 AUDITIMET E FONDEVE TË DONATORËVE.....	24
5. FOKUSI I ARDHSHËM.....	25
6. LLOGARIDHËNIA E ZAP.....	27
SHTOJCA 1: PARATHËNIE E SHKURTËR PËR ZAP.....	28
SHTOJCA 2: PASOYRAT VJETORE FINANCIARE DHE ADRESIMI I REKOMANDIMEVE PËR VITIN 2012.....	31
SHTOJCA 3: OPINIONI I AUDITORIT TË JASHTËM PËR VITIN 2013.....	38

SHKURTIMISHT RRETH ZAP

Misioni jonë është të “kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar të administratës publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në pajtim me standardet e auditimit në sektorin publik të pranura ndërkombëtarisht dhe praktikat e mira Evropiane. Ne do të krijojmë besueshmëri në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesave të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit përmes rritjes së llogaridhënies publike”

Vizioni ynë është që të kemi në vend një Institucionin Suprem të Auditimit (ISA), Zyrën Kosovare Kombëtare të Auditimit, të zotëruar plotësisht nga kosovarët dhe e konsideruar nga partnerët ndërkombëtarë dhe palët vendore të interesit si një ISA që vepron mirë.

Si veprojmë? Perspektiva jonë e auditimit të jashtëm ndihmon Kuvendin që të kërkojë llogari nga Qeveria dhe të përmirësojë shërbimet publike. Ne auditojmë pasqyrat vjetore financiare të të gjitha organizatave buxhetore dhe përveç kësaj ne kryejmë auditime jo statutore me synim përmirësimin e shërbimeve dhe ofrimin e tyre me kosto efektive.

Ne jemi të dedikuar që jo vetëm të ofrojmë informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike, por edhe të ndihmojmë organet tona të audituara që të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke i shtuar kështu vlerë veprimtarive të tyre.

Ne jemi të dedikuar që të ndihmojmë në ndërtimin e qeverisjes së mirë në Administratën Publike duke iu përgjigjur pritshmërive.

1. PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS

Auditime në kohë, me cilësi, dhe relevancë

Sezoni i auditimit 2012/13 përfundoi në fund të gushtit 2013. Ne raportuam 108 auditime në total. Më hollësisht, ne kemi dorëzuar:

- Raportin statutor të auditimit të BK-së;
- Tetëdhjetë e tetë raporte statutorë të auditimit në kuadër të BK-së;
- Një raport statutor të auditimit jashtë BK-së;
- Gjashtëmbëdhjetë auditime jo-statutorë; dhe
- Dy auditime të fondeve të donatorëve.

Sezoni i auditimit 2013/14 ka filluar në shtator 2013 dhe planifikojmë të raportojmë 114 auditime:

- Raportin statutor të auditimit të BK-së;
- Tetëdhjetë e tetë raporte statutorë të auditimit në kuadër të BK-së;
- Shtatëmbëdhjetë auditime jo-statutorë; dhe
- Tetë auditime të fondeve të donatorëve.

Asistimi në zhvillimin e qeverisjes së mirë dhe MFK-së

- Ne kemi zhvilluar më tej marrëdhënien me Kuvendin. Përveç Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP), i cili shfrytëzon raportet tona si një input për të kërkuar llogari nga menaxherët, ne kemi filluar gjithashtu të punojmë me komisione të tjera në mënyra të ndryshme; dhe
- Konkluzionet tona të auditimit në mënyrë aktive kanë mbështetur intervenimet me degën e ekzekutivit dhe projektet e ndryshme në fushën e MFP-së duke krijuar një bazë të shëndoshë për qeverisje të mirë, transparencë dhe llogaridhënie.

Modernizimi i qeverisjes korporative

- Ne kemi zbatuar Strategjinë dalëse të Auditorit të Përgjithshëm duke forcuar qëndrueshmërinë dhe pronësinë;
- Bazuar në ri-organizimin e brendshëm, janë qartësuar linjat e llogaridhënies dhe është funksionalizuar një shkallë më e lartë e delegimit të brendshëm;
- I gjithë stafi jonë ka arritur të kuptojë më thellë bazën, kontekstin, dhe teknikat e Institucioneve Supreme të Auditimit përmes prezantimit të programit të ri të certifikimit për auditorë të sektorit publik;
- Marrëveshje bashkëpunimi afatgjate me partnerët tanë ndërkombëtarë, si dhe veprimet me të cilat vendosim veten si partnerë në bashkëpunim ndërkombëtar dhe evropian mes Institucioneve Supreme të Auditimit janë të vendosura; dhe

- Ne kemi stimuluar profesionalizmin dhe efikasitetin, si dhe zhvillimin e mjeteve dhe instrumenteve të reja që sigurojnë një rezultat të orientuar kah qasja, fokusi, produktiviteti, dhe kontrolli i mirë menaxherial.

Llogaridhënia

- Ne kemi dorëzuar Raportin Vjetor të Performancës për vitin 2012 me kohë dhe kemi diskutuar atë në KMFP, si bazë për të kërkuar llogari nga Auditori i Përgjithshëm për mënyrën se si ai ka menaxhuar zyrën.



2. TREGUESIT E REZULTATEVE

Këtu ne do të prezantojmë aktivitetet tona operative dhe rezultatet duke përdorur tregues sasior dhe cilësor, të cilët mundësojnë krahasimin. Ne duhet të shikojmë:

- 2.1 Mbulimin me auditim – që matet në aspektin e madhësisë së Buxhetit të Kosovës që mbulohet me auditimet statutore dhe numrin e raporteve të auditimeve tjera të dorëzuara;
- 2.2 Cilësinë e auditimeve dhe raporteve tona – që matet me numrin e auditimeve të përfunduara dhe raporteve të publikuara që i nënshtrohen Sistemit për Menaxhimin e Cilësisë;
- 2.3 Ndikimin–që matet me numrin e takimeve të mbajtura nga KMFP për rishikimin e raporteve tona, nivelin e rekomandimeve tona të adresuara nga entitetet e audituara dhe konkluzionet në opinione të auditimit; dhe
- 2.4 Vlerësimet e jashtme dhe të brendshme – që maten në aspektin e pikëpamjeve të dhëna nga partnerët tanë të jashtëm dhe të brendshëm në vlerësimet e tyre përkatëse për performancën tonë organizative dhe besueshmërinë e punës tonë.

2.1 MBULIMI ME AUDITIM

Në përputhje me mandatin tonë të auditimit, ne kryejmë si auditime statutore¹ ashtu edhe auditime jo-statutore². Auditimet statutore të rregullsisë kryhen në baza vjetore dhe raportohen në një afat të qartë kohor, ndërsa auditimi jo-statutor raportohet në baza të vazhdueshme. Të dyja këto forma të auditimit, në mënyra të ndryshme, mbështesin llogaridhënien në procesin e shpenzimit të buxhetit.

Ne, në mënyrë progresive kemi rritur mbulimin me auditime jo-statutore. Gjatë sezonit të auditimit 2009/10, kemi kryer katër auditime jo-statutore, të cilat tani janë rritur në 17 për sezonin aktual të auditimit. Ky përparim në rritjen e numrit të auditimeve jo-statutore është arritur edhe me rritjen e numrit të stafit si dhe mbështetjes së jashtme shtesë për ekipet.

Ashtu si në vitet e mëparshme, ne kemi vazhduar trendin e rritjes së madhësisë së Buxhetit të Kosovës që mbulohet nga auditimi ynë.

Në shtator të vitit 2013, kemi filluar me auditimet e ndërmjetme të rregullsisë për organizatat buxhetore, dhe kemi ofruar Memot e Auditimit përkatëse në dhjetor, e që janë pararendës të raporteve vjetore të auditimit që finalizohen në mes të vitit 2014. Auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore financiare për vitin 2013 mbulon të gjitha Organizatat Buxhetore përveç Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI)³, që përfaqëson 100% të të hyrave totale dhe 99% të shpenzimeve totale të Buxhetit të Kosovës.

Raporti Vjetor i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Buxhetit të Kosovës për vitin 2012, ishte hartuar duke u bazuar në të gjeturat nga auditimet individuale, dhe i është dorëzuar Kuvendit në fund të gushtit të vitit 2013. Në tetor, Raporti Vjetor i Auditimit është prezantuar para Kuvendit nga Auditori i Përgjithshëm dhe është diskutuar në seancë të hapur plenare.

¹ Ne i referohemi auditimeve statutore si auditime të rregullsisë pas ato përfshijnë auditimin e pasqyrave financiare dhe të pajtueshmërisë.

² Auditimet jo-statutore përfshijnë auditime të performancës, menaxherial ose të sistemit dhe nuk kanë kufizime kohore ligjore për dorëzimin e tyre.

³ Për shkak të kornizës së saj ligjore dhe nevojën për të qenë subjekt i një regjimi të veçantë auditimi.

Numri i Raporteve të Auditimit

Në fund të sezonit të auditimit 2012/2013 kemi publikuar 108 raporte të auditimit:

- Raportin e Auditimit të BK-së;
- Tetëdhjetë e tetë raporte të auditimit të rregullsisë në kuadër të BK-së;
- Një raport të auditimit statutor jashtë BK-së;
- Një auditim i bazuar në sistem – Auditimi i sistemit SIGTAS;
- Pesë auditime të performancës: Menaxhimi i mbeturinave medicinale, Kompanitë rajonale të mbeturinave si: Ambienti (Pejë), Çabрати (Gjakovë), Ekoregjioni (Prizren) dhe Pastrimi (Prishtinë);
- Dhjetë auditime menaxheriale: Infrakos, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Menaxhimi i Pyjeve- Agjencia e Pyjeve të Kosovës, Menaxhimi i licencave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Menaxhimi i prokurimit për investime kapitale në Komunën e Mitrovicës dhe Shtimës, Policia e Kosovës, QKUK, Ministria e Infrastrukturës dhe Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale; dhe
- Dy auditime të fondit të donatorëve në lidhje me “Promovimin e Punësimit përmes zhvillimit biznesit dhe aftësive” (DANIDA).

Sezoni i auditimit 2013/14 ka filluar në shtator 2013 dhe kemi në plan të raportojmë 114 auditime:

- Raportin e Auditimit të BK-së;
- Tetëdhjetë e tetë raporte të auditimit të rregullsisë në kuadër të BK-së;
- Shtatëmbëdhjetë auditime të performancës: Përdorimi i automjeteve zyrtare, Bursat për arsimin e lartë, Pajisjet mjekësore, Radio Televizioni i Kosovës, Sistemi i prokurimit në sektorin e shëndetësisë dhe Mirëmbajtja e riparimi i automjeteve zyrtare, Mbikëqyrja e sistemit të mbeturinave, PPP e Aeroportit të Prishtinës, Njehsorët elektrik, Kompensimet për Bordet e Drejtorëve të NP-ve qendrore 2009-2012, Shpronësimi i pronës, Siguria në rrugë, Agjencia e Statistikave, Shpërndarja e mirëqenies sociale, Pikë referimi i indikatorëve në komuna, Ndërmarrja Publike Banesore në Zveçan dhe Shpenzimet e udhëtimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme; dhe
- Tetë auditime të fondeve të donatorëve: Asistencë teknike për zhvillimin e bujqësisë (TAMAD), Nxitja e punësimit përmes biznesit dhe zhvillimit të aftësive (DANIDA) dhe gjashtë nga dymbëdhjetë projekte në dymbëdhjetë komuna të ndryshme⁴ të bashkë-financuara nga UN-Habitati dhe komunat përkatëse.

Tabela 1 tregon portofolion tonë të përgjithshme të auditimit, përfshirë numrin dhe llojet e auditimeve të kryera në 2013/14 të paraqitur me një bazë krahasuese për tre vitet e fundit. Për sezonin aktual të auditimit, fokusi ynë kryesor ishte në konsolidimin e auditimit tonë të rregullsisë, zhvillimin e auditimeve jo-statutore në aspektin e mbulimit, cilësisë dhe fokusit si dhe auditimin e më shumë projekteve të financuara nga donatorët.

Gjatë vitit 2014 ne do të fillojmë me auditimin e projektit të fondit të përbashkët të donatorëve në Ministrinë e Arsimit. Ne presim të rrisim numrin e auditimeve të tilla në të ardhmen, pasi besimi i donatorëve ndërkombëtar për profesionalizmin dhe besueshmërinë në punën tonë të auditimit është rritur dhe duke e bërë këtë, hapim rrugë për përkrahje të drejtpërdrejtë buxhetore.

⁴ Deçan, Dragash, Hani i Elezit, Junik, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Malishevë, Mamushë, Skënderaj dhe Viti janë auditimet e kontraktuara jashtë.

Tabela 1: Numri dhe lloji i auditimeve të kryera gjatë sezoneve

Llojet e auditimit	Sezoni i auditimit	Sezoni i auditimit	Sezoni i auditimit
	2013/2014	2012/2013	2011/2012
Auditimet statutore	89	90	87
BK	1	1	1
Autoritetet Shtetërore	24	24	25
Komunat	38	38	37
Të kontraktuara	-11	-11	-18
Institucionet e pavarura	25	26	24
Jashtë BK-së	0	1	0
Auditimet jo-statutore	17	16	14
Auditimet Menaxheriale	0	10	8
Auditimet e Performancës	17	5	4
Auditimet e sistemit	0	1	2
Auditimi i fondeve të donatorëve	8	2	1
Totali	114	108	102

Në nivel të qeverisjes lokale, ne kemi vazhduar kontraktimin e punës tonë tek firmat private të auditimit për të kryer auditime në disa komuna. Numri i auditimeve të kontraktuara ka mbetur i njëjtë si një vit më parë. Ne synojmë të mbajmë këtë praktikë në të ardhmen si mënyrë për të krahasuar cilësinë e auditimeve tona me ato të sektorit privat edhe pse plani ynë është që me kalimin e kohës të zvogëlojmë numrin e auditimeve të kontraktuara. Auditimin e ardhshëm ne presim të zvogëlojmë numrin në gjashtë.

Tabela 2: Auditimet e Komunave të kontraktuara tek firmat private të auditimit

	2013/14	2012/13	2011/12
Numri i auditimeve	11	11	18
Numri i firmave të auditimit	1	1	2
Kosto	44,900	42,900	94,000

2.2 CILËSIA E RAPORTEVE TONA

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë (SMC) mbetet një ndër prioritetet kryesore të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Për këtë, ne kemi hartuar politika dhe procedura për ta përfshirë të kuptuarit e cilësisë si kërkesë themelore.

Bazuar në këtë, ne kemi integruar një sistem të monitorimit të cilësisë, i cili siguron se auditimet e përfunduara janë në pajtim të plotë me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorin Publik (SNKSP-të) si dhe me praktikat e mira evropiane. Ky sistem siguron se auditimet janë të dokumentuara mirë, të përfunduara me kohë si dhe me cilësi të lartë.

SMC përbehet nga tri komponente kryesore:

- Kontrolli i cilësisë;
- Monitorimi i cilësisë; dhe
- Sigurimi i cilësisë.

Kontrolli i cilësisë për secilin auditim individual mbulon rishikimin mbikëqyrës në gjithë procesin e auditimit përfshirë: vlerësimin e saktësisë dhe plotësisë të planeve të auditimit, përdorimin e dokumentacionit standard gjatë dokumentimit të auditimit, rishikimin në fazën e raportimit, si dhe përcjelljen e vazhdueshme lidhur me adresimin e rekomandimeve.

Të gjitha auditimet e pasqyrave financiare të vitit 2012 janë monitoruar në vazhdimësi nga Menaxhmenti, që nga Udhëheqësi i Ekipit të Auditimit, Drejtori i Auditimit, Asistent Auditori i Përgjithshëm e deri te Auditori i Përgjithshëm. Përveç kësaj, si pjesë integrale e këtij sistemi ishin edhe rishikimet gjuhësore dhe ligjore si dhe janë ofruar formate të njëjta për raportet e auditimit. Edhe shablloni për raportet e auditimit është futur në përdorim.

Monitorimi i cilësisë është funksion i rishikimit të brendshëm, i cili kryhet nga Departamenti i Mbështetjes së Auditimit. Monitorimi i cilësisë edhe gjatë vitit 2013 është mbështetur nga partnerët tanë ndërkombëtar. Ky proces ka mbuluar të gjitha fazat e auditimit për të siguruar se auditimi është përfunduar në pajtueshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit, ligjet vendore si dhe me politikat dhe procedurat e vendosura.

Në sezonin e auditimit 2012/2013, Departamenti për Mbështetje të Auditimit ka monitoruar 13 auditime, nga të cilat 12 auditime të rregullsisë dhe një auditim menaxherial derisa partnerët tanë ndërkombëtarë kanë monitoruar gjithsej gjashtë auditime të rregullsisë.

Gjatë fazës së planifikimit të auditimit për 2013/14, Departamenti i Mbështetjes së Auditimit në bashkëpunim me Partnerët Ndërkombëtar kanë monitoruar 17 auditime. Këto auditime vazhdojnë të monitorohen gjatë sezonit 2013/14 në lidhje me fazën e përfundimit të punës në teren si dhe fazën e raportimit.

Sigurimi i cilësisë është një rishikim i pavarur pas auditimit, i cili behët përmes një kombinimi të rishikimit të brendshëm dhe të jashtëm. Ky rishikim bëhet në periudha kohore më të gjata se një vit, d.m.th çdo tri ose katër vite. Hera e fundit kur ne kemi kryer një rishikim të tillë brenda institucionit tonë për auditime jo-statutore ishte në muajin maj të vitit 2011 dhe për auditime jo-statutore në tetor 2012.

Ne jemi duke i kushtuar vëmendje të veçantë cilësisë së punës sonë dhe raporteve të hartuara. Ne jemi të vetëdijshëm për nevojën e ngritjes së mëtejme të cilësisë. Prandaj, çdo vit bazuar në mësimet e nxjerra dhe reagimet e marra, ne kemi bërë ndryshime pozitive në mënyrën se si janë kryer auditimet dhe se si janë raportuar rezultatet. Ne jemi të përkushtuar në konsolidimin e auditimeve tona statutores si dhe zhvillimin e cilësisë dhe fushëveprimit të atyre jo-statutore. Partnerët tanë të ndryshëm janë duke na ndihmuar në arritjen e këtyre objektivave të cilësisë.

2.3 NDIKIMI

Ne e masim ndikimin e punës sonë bazuar në shkallën në të cilën komisionet parlamentare përdorin raportet tona si input për vendimmarrje dhe funksionin mbikëqyrës, në shkallën në të cilën organizatat e audituara e çmojnë vlerën e punës sonë dhe pranojnë profesionalizmin tonë në fushën e MFK-së dhe në nivelin në të cilin puna jonë identifikon mundësitë për kursime dhe ndryshim pozitiv me potencial që të shpie në përmirësime të qëndrueshme në të gjithë sektorin publik.

Ne kemi kryer auditime në organizata të ndryshme të sektorit publik, duke përfshirë organizatat qeveritare qendrore, institucionet dhe organet e pavarura, ndërmarrjet publike dhe komunat. Kjo qasje dhe përvojë na dha një kuptim të gjerë të menaxhimit të përgjithshëm të financave publike, sfidave dhe mundësive të tij të ndryshme. Kjo na vënë në një pozitë ku duhet të identifikojmë praktika të mira dhe ti ndajmë ato me organizatat e sektorit publik. Në këtë mënyrë ne kontribuojmë në ndryshim dhe përmirësim të qëndrueshëm.

Raportet tona të dorëzuara në Kuvend kanë dhënë kontribut të konsiderueshëm në dëgjimet publike të KMFP-së ku përfaqësues të Qeverisë japin llogari për mënyrën se si menaxhohen burimet publike. Në këto takime u diskutuan 17 raporte tona individuale të auditimit dhe Raporti Vjetor i Auditimit dhe

nga persona të përgjegjshëm është kërkuar të ndërmarrin veprime dhe bëjnë përmirësime. Ne kemi marrë pjesë aktive në të gjitha këto takime.

Gjatë auditimeve të ndërmjetme dhe atyre finale në organizatat e audituara kemi raportuar të gjetura të ndryshme të auditimit dhe kemi dhënë këshilla e rekomandime se si duhet përmirësuar qeverisja e brendshme, menaxhimi financiar dhe kontrollat. Në këtë mënyrë, ne ndihmuam në krijimin e parakushteve themelore për përdorim më të mirë të burimeve publike, me kosto efektive të ofrimit të shërbimit, të llogaridhënies dhe të transparencës. Nëpërmjet raporteve tona të ndryshme të auditimit, kemi identifikuar çështjet të cilat mund të kenë rezultuar në përdorim joefikas, shpërdorim dhe/ose menaxhim jo të duhur të burimeve publike dhe veprimeve të rekomanduara që ofrojnë potencial të rëndësishëm për përmirësime. Organizatat të cilat vepruan sipas rekomandimeve tona bënë kursime dhe përmirësime.

OPINIONET E AUDITIMIT

Opinionet e auditimit të dhëna për Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2012 pasqyrojnë një numër në rritje të opinionëve të pakualifikuara me theksim të çështjes.

Organizatat Buxhetore janë duke i përmirësuar proceset e tyre duke mbështetur hartimin e Pasqyrave Vjetore Financiare. Kjo deri diku është rezultat i këshillave dhe rekomandimeve tona të auditimit.

Tabela 3 Opinionet e Auditimit të dhëna gjatë tre viteve të fundit

Pasqyrat vjetore financiare	2012	2011	2010
Llojet e opinionëve të auditimit			
Opinion i pakualifikuar	38	35	15
Opinion i pakualifikuar me Theksim të Çështjes	42	32	35
Opinion i kualifikuar	2	15	19
Opinion i kualifikuar me Theksim të Çështjes	6	4	0
Opinion i kundërt	0	0	3
Mohim i opinionit	3	3	9
Totali	91⁵	89	81

Përveç angazhimeve tona të auditimit, ka edhe punë të tjera që ne kemi kryer për të mbështetur përmirësimet në qeverisjen e mirë. Për këtë qëllim, ne po kryejnë një studim në sektorin e shëndetësisë, i cili do të kontribuojë për reformën në vazhdim. Ne, gjithashtu kemi marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues të KBFP-së duke u fokusuar në zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe të auditimit të brendshëm në sektorin publik. Në vijim të kësaj, disa organizata të audituara kanë kërkuar ndihmë dhe këshilla nga ne, kur u ballafaquan me vështirësi të caktuara procedurale në operacionet e tyre financiare. Pas rekomandimit tonë, u krijua një komision ndërqeveritar me qëllim të zgjidhjes së problemeve me sistemet e regjistrimit të pasurisë. Ne kemi marrë pjesë si vëzhgues.

NUMRI DHE PËRQINDJA E REKOMANDIMEVE TË ADRESUARA

Në secilin prej raporteve tona të auditimit ne japim rekomandime për udhëheqësit e organizatave të audituara që të përmirësojnë cilësinë e raportimit financiar, të rrisin menaxhimin financiar dhe kontrollin brenda institucioneve të tyre. Nëpërmjet rekomandimeve tona, ne mbështesim organizatat që të ofrojnë shërbime më të mira për qytetarët, për të përdorur burimet e pakta në mënyrë më efikase dhe për të përmirësuar cilësinë e informacionit për vendimmarrje dhe transparencë. Në këtë mënyrë, ofrojmë kontribut në procesin e Qeverisë për ndërtimin e qeverisjes së mirë.

⁵ Numri i përgjithshëm prej 91 opinionëve përfshin opinionin për Programin DANIDA (auditimin e fondit të donatorëve) dhe opinionin për NP "Trepça".

Derisa ne i kryejmë auditimet tona, ne gjithashtu përqendrohemi shumë edhe në përcjelljen dhe analizimin e mënyrës se si janë zbatuar rekomandimet tona të vitit të kaluar. Një analizë e tillë ka qenë objekt i punës sonë në të gjitha auditimet individuale të organizatave buxhetore. Rezultatet nga këto analiza janë përmbledhur në tabelën 4. Ne kemi klasifikuar organizatat e audituara si organizata të nivelit qendror (ministritë, zyra e Presidentit dhe Kryeministrit, dhe Administrata e Kuvendit), institucionet e pavarura dhe komunat.

Ne kemi dhënë këshilla se si të sigurohet një ndikim dhe ndryshim i qëndrueshëm. Raportet e auditimit po ashtu përmbajnë një kapitull të veçantë për rekomandimet e mëhershme.

Tabela 4: Adresimi i rekomandimeve të dhëna në PVF për 2011

Entitetet e audituara	Rekomandimet	Plotësisht të adresuara		Pjesërisht të adresuara		Të pa adresuara	
		Nr	%	Nr	%	Nr	%
Organizatave Qeveritare	199	54	27	100	50	45	23
Institucionet e pavarura	157	86	55	43	27	28	18
Komunat	306	80	26	113	37	113	37
	662	220	33	256	39	186	28

Krahasuar me vitet e mëparshme, ne mund të arrijmë në përfundimin se ekziston përmirësim i vazhdueshëm në implementimin e rekomandimeve. Gjendje më e mirë është tek institucionet e pavarura, Ministritë kanë nivel përafërsisht të njëjtë të implementimit të rekomandimeve me vitin e kaluar, derisa komunat kanë shënuar përmirësim të lehtë.

Përveç rekomandimeve të dhëna, ne kemi dhënë gjithashtu këshilla gjatë fazës së auditimit të ndërmjetëm në lidhje me hapat që duhet të ndërmerren për përmirësimin e mëtejshëm të menaxhimit dhe raportimit financiar. Një pjesë e mirë e tyre, e sidomos këshillat që lidhen me përgatitjen e pasqyrave financiare, janë adresuar nga ana e organizatave buxhetore, duke përmirësuar kështu edhe cilësinë e informacioneve të shpalosura në Pasqyrat Vjetore Financiare.

Me gjithë progresin e arritur, ne ende kemi shqetësime në lidhje me progresin e implementimit të rekomandimeve tona, ritmi i të cilit do të duhej të jetë shumë më i shpejtë, sidomos te komunat dhe Ministritë.

Në të kaluarën, rekomandimet e përgjithësuara mund të kenë qenë shkak për mos adresim të plotë. Prandaj, ne i kemi bërë rekomandimet tona më konkrete, të matshme dhe të lehta për tu adresuar. Megjithatë, organizatat buxhetore duhet të implementojnë procese sistematike për të adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

2.4 VLERËSIMI I JASHTËM DHE I BRENDSHËM

Rivlerësimi konstant për efektshmërinë e veprimeve tona është domosdoshmëri në këtë mjedis, i cili vazhdimisht ndryshon.

Operacionet tona janë vlerësuar nga brenda dhe jashtë. Auditimi i Pasqyrave tona Vjetore Financiare për vitin 2012 rezultoi në opinion të pakualifikuar, ndërsa rekomandimet e dhëna në letrën e menaxhmentit janë adresuar në mënyrën e duhur.

Proceset tona vlerësohen në vazhdimësi nga partnerët tanë ndërkombëtarë si dhe janë marrë veprimet e duhura për të përballuar ambientin dinamik dhe për të qenë në përputhje me praktikën e mira në bazë të të cilave një ISA duhet të operojë. Si pjesë e vlerësimit të brendshëm, operacionet

tona janë vlerësuar vazhdimisht nga auditimi i brendshëm, i cili vlerëson efektivitetin e sistemeve tona të brendshme.

Një bashkëveprim efektiv mes ZAP dhe deputetëve të KMFP-së është nxitur edhe më tej. Ne i kushtuam vëmendje nevojave parlamentare gjatë planifikimit të punës sonë dhe hartimit të raporteve tona. Ne ndihmuam komisionet e Kuvendit të organizojnë debate të informuara duke u ofruar atyre një gamë të produkteve për të mbështetur punën e tyre. Informimi i deputetëve të KMFP-së në takim përgatitor para fillimit të seancave dëgjimore dhe orientimi i tyre në çështjet më të rëndësishme është pjesë përbërëse e ndërveprimit tonë. Kjo reflektohet në mënyrën se si janë diskutuar raportet individuale dhe RVP dhe më pas janë rekomanduar masat për përmirësim. Përveç kësaj, në vitin 2013, përfaqësuesit e KMFP-së dhe ZAP-së morën pjesë në një vizitë studimore në Mbretërinë e Bashkuar dhe në një nga konferencat rajonale për ISA-të qëllimi i të cilave ishte shkëmbimi i përvojave në bashkëpunimin mes ISA-ve dhe komisioneve parlamentare.

Ky bashkëpunim ishte bazuar në kuptimin e fortë dhe respektimin e roleve dhe mandatit të pavarur të njëri-tjetrit dhe është konsideruar si reciprokisht e dobishme. Kur u diskutua RVP 2012 në Kuvend në seancën plenare, shumë deputetë njohën vlerën e punës të ofruar nga ZAP dhe shprehën besimin e tyre në pavarësinë e aktiviteteve të auditimit.

Për sa i përket vlerësimeve të bëra, Raporti i Progresit 2013 nga BE-ja për Kosovën, i publikuar në tetor 2013, mes arritjeve të tjera thekson se ZAP duhet të shtojë përpjekjet në ruajtjen e zbatimit të strategjisë së re zhvillimore, e cila fokusohet në qëndrueshmërinë e institucionit dhe paraqitjen e mëtejshme të praktikave më të mira të BE-së.

Puna jonë është analizuar me kujdes dhe e njohur nga partnerët tanë ndërkombëtarë. Për më tepër, operacionet tona si zakonisht janë vlerësuar nga stafi ynë dhe palët tona të interesit në konferencat tona vjetore. Ky lloj i ngjarjes na ndihmon të identifikojmë dobësitë dhe mundësitë për tu përmirësuar në adresimin e sfidave të ardhshme.

3. BURIMET

Burimi kryesor i financimit të ZAP është Buxheti i Kosovës. Pagat e Auditorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Kabinetit/Ushtuesit të detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm bashkë-financohen nga Qeveria e Suedisë dhe Buxheti i Kosovës dhe administrohen nga Grupi Menaxhues Ndërkombëtar (GMN).

Përveç kësaj, tanimë ne gjenerojmë të hyra nga auditimet e projekteve të financuara nga donatorët. Këto të hyra depozitohen drejtpërsëdrejti në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe nuk përfshihen në buxhetin e ZAP-it. Ne gjithashtu marrim donacione nga parterët tanë, me të cilët bashkëpunojmë.

3.1 BURIMET NGA BUXHETI I KOSOVËS

Buxheti fillestar për vitin 2013 ishte 2,120,453€. Gjatë vitit fiskal, në buxhetin tonë janë bërë ndryshime si në vijim:

- Në qershor – Ambasada Britanike në Prishtinë bashkëfinancoi modulën 'Qeverisja, rreziku dhe kontrolli', në shumën 14,268€, për trajnimin e trajnerëve;
- Në gusht – Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë dhuroi 7,000€ për të bashkëfinancuar konferencën e pestë vjetore të ZAP-it të mbajtur në Ohër, Maqedoni. Përveç kësaj, edhe Bashkimi Evropian e financoi konferencën vjetore;
- Në shtator - Me propozimin tonë, Qeveria e Kosovës mori vendim për reduktim të ndarjes buxhetore të ZAP-it për vitin 2013 në vlerë prej €50,000 duke tërhequr €25,500 nga kategoria e Subvencione dhe Transfere⁶, €20,000 nga Paga dhe Mëditje dhe €4,500 nga Mallra dhe Shërbime;
- Në dhjetor - Me qëllim të përmirësimit të zbatimit të prokurimit publik në Kosovë, Banka Botërore ka mbështetur zyrën tonë nëpërmjet një projekti 20 mujor, duke u fokusuar drejt zhvillimit të aftësive profesionale në auditimin e sistemeve të prokurimit dhe marrjen e vendimeve të duhura afariste në prokurim. Kësti i parë në vlerën 29,334€ u alokua në buxhetin tonë në fund të Dhjetorit

Pas këtyre ndryshimeve, buxheti ynë në fund të vitit ishte 2,121,055€.

⁶ Pjesa e mbetur prej €100.000 nga buxheti për Subvencione & Transfere u transferua nga Ministria e financave në GMN për bashkëfinancimin e Auditorit të Përgjithshëm për periudhën deri në fund të gushtit 2014.

Tabela 5: Buxheti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

(në Euro 000)


Raporti i buxhetit	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	Përqindje
2013				
Buxheti i përgjithshëm	2,120	2,121	2,006	95%
Pagat dhe Mëditjet	1,305	1,285	1,268	99%
Mallrat dhe Shërbimet	620	666	614	92%
Shërbimet komunale	45	45	29	64%
Transferet & subvencionet	100	75	75	100%
Investimet Kapitale	50	50	20	41%
2012				
Buxheti i përgjithshëm	2,010	1,937	1,822	94%
Pagat dhe Mëditjet	1,198	1,215	1,174	97%
Mallrat dhe Shërbimet	622	622	561	90%
Shërbimet komunale	40	40	32	80%
Transferet & subvencionet	100			0%
Investimet Kapitale	50	60	55	92%
2011				
Buxheti i përgjithshëm	1,810	1,866	1,728	93%
Pagat dhe Mëditjet	1,098	1,098	1,036	94%
Mallrat dhe Shërbimet	672	648	575	89%
Shërbimet komunale	40	38	35	92%
Transferet & subvencionet		60	60	100%
Investimet Kapitale		22	22	100%

- Gjatë tre viteve të fundit, buxheti i Zyrës ka shënuar rritje të vazhdueshme. Buxheti final në vitin 2013 ishte për 9.5% më i lartë krahasuar me atë të vitit 2012, derisa buxheti i vitit 2012 ishte për 3.8% më i lartë krahasuar me atë të vitit 2011;
- Në vitin 2013 shuma e shpenzimeve në kategorinë Paga dhe Mëditje ishte për 8% më e lartë krahasuar me vitin 2012. Kjo rritje është si rezultat i kostove më të larta të personelit si dhe numrit më të madh të udhëheqësve të ekipit; dhe
- Rritja e buxhetit për kategorinë Mallra dhe Shërbime në vitin 2013 ka ndodhur si rezultat i donacioneve të pranuar.


Pas rishikimit të buxhetit, ne kemi bartur tre projekte kapitale në vitin 2014 duke paraparë ndërkohë tre projekte të tjera kapitale. Vonesat në aprovimin e Ligjit për rishikim të buxhetit për vitin 2013 ka ndikuar në afatet kohore të procedurave tona të prokurimit. Për më tepër, dështimi i një kompanie

për të ofruar mallrat brenda vitit fiskal si dhe nevoja e vazhdueshme për përsëritje të prokurimit për shkak të mungesës së ofertuesve të përgjegjshëm ishin faktorët kyç që çuan në një nivel krahasimisht të ulët të zbatimit të projekteve kapitale sipas planifikimit.

Grafiku 1. Shpenzimet buxhetore sipas kategorive ekonomike



Grafiku 2. Shpenzimet buxhetore në kategorinë Mallra e Shërbime



Për sa i përket Mallrave dhe Shërbimeve, siç shihet edhe në grafik, qiraja është kosto më e lartë. Përveç kësaj:

- 18% e shpenzimeve buxhetore kanë të bëjnë me trajnimet profesionale. Shumica e tyre është shpenzuar për financimin e programit për certifikimin e auditorëve, duke ndjekur skemën e re të certifikimit për sektorin publik sipas një marrëveshje të nënshkruar në korrik

të vitit 2013. Këtu përfshihet gjithashtu donacioni i dhënë nga Ambasada Britanike për financimin e programit për trajnimin e trajnerëve, i cili është mbajtur nga CIPFA;

- 13% e shpenzimeve buxhetore kanë të bëjnë me kontraktimin e firmave private të auditimit për kryerjen e auditimit të 11 komunave për vitin 2013. Krahasuar me vitin e kaluar, ky numër është zvogëluar, duke reduktuar kështu shpenzimet e vitit aktual⁷. Përveç kësaj, një pjesë e kësaj ka të bëjë me shërbime të pastrimit, përkthimit dhe auditimit të cilat janë angazhuar përmes kontratave të përkohshme individuale; dhe
- 11% e shpenzimeve buxhetore kanë të bëjnë me shpenzimet e udhëtimit brenda Kosovës dhe jashtë saj. Shumica e tyre janë shpenzuar si kosto shtesë për auditimin e komunave që gjenden në distancë mbi 50km nga Prishtina. Shpenzimet përfshijnë akomodimin, ushqimin dhe mëditjen. Një pjesë e tyre janë shpenzuar për pjesëmarrje në punëtori/konferenca jashtë vendit si dhe për auditimin e ambasadave të Republikës së Kosovës.

3.2 MENAXHIMI I PASURISË FIKSE

Të gjitha veturat tona zyrtare kanë vlerën neto zero për vitin 2013. Blerje të reja janë bërë në lidhje me nevojat tona. Përveç kësaj, ne kemi pasur një numër kompjuterësh që nuk përdoren më, të cilët ia kemi dhuruar njëres prej shkollave fillore 'Hilmi Rakovica'.

3.3 BURIMET NJERËZORE

Aftësitë dhe përvoja e të gjithë njerëzve tanë janë element thelbësor për organizatën. Në fund të vitit 2013, ZAP ka punësuar 144 punëtorë. Nga ky numër i punëtorëve, 138 kanë kontratë të rregullt punësimi ndërsa gjashtë janë angazhuar si zëvendësues për stafin në pushim të lindjes. Auditori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Kabinetit/Ushtuesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm janë me kontrata të veçanta. Përveç kësaj, katër punëtorë janë angazhuar me anë të marrëveshjes për shërbime të veçanta.

Krahasuar me vitin 2012, ne kemi rritur numrin e të punësuarve që financohen nga BK-ja me katër të tjerë, duke arritur kështu shumën e 144 të punësuar, nga të cilët 67 femra dhe 77 meshkuj. Moshën mesatare e të punësuarve është 37.1 vjeç.

Kjo rritje e numrit të personelit është në pajtueshmëri me marrëveshjen për PVPE të arritur mes Qeverisë dhe Zyrës së Bashkimit Evropian për ngritjen e kapaciteteve të ZAP-it.

Si rezultat i kësaj, ne kemi siguruar një rritje të stafit në përputhje me nevojat tona aktuale. Mundësia për të angazhuar auditorë në projekte të veçanta të auditimit të fondeve të donatorëve na ofron një mënyrë të lehtë për t'iu përshtatur nevojave që ndryshojnë.

Në tabelat e mëposhtme mund të gjeni disa statistika bazë në lidhje me zhvillimin e personelit gjatë viteve të fundit.

⁷ Kosto për auditimin e kontraktuar ishte pak më e lartë krahasuar me vitin e mëparshëm për shkak të vëllimit të punës së auditimit të kryer. Në auditimin e sezonit 2013/14 janë kryer edhe faza e ndërmjetme edhe faza përfundimtare, kurse në auditimin 2012/14 është kryer vetëm faza përfundimtare.

Tabela 6: Personeli nëpër vite

Viti	Tavani person elit	Numri i komuniteteve	Përqindja e femrave	Numri i drejtorëve (femra)	Mosha mesatare	Numri i udhëheqësve të ekipit	% Lëvizja e personelit	Përvoja në zyrë më e gjatë se dy vite
2008	85	4	17.5%	1	37.4	N/A ⁸	11.8	56
2009	106	5	24.7%	2	38.5	14	13	59
2010	116	6	38.6%	3	36.8	22	5.2	67
2011	130	6	43.7%	5	37.0	26	3.2	73
2012	136	6	45.8%	5	36.7	29	0.7	108
2013	140	6	47.9%	6	37.1	38	3.75% ⁹	127

Tabela 7: Kategoritë e personelit (në pozitë në fund të vitit)

Kategoria	2013		2012		2011	
	Shifra aktuale	Pozitat	Shifra aktuale	Pozitat	Shifra aktuale	Pozitat
Personeli auditues	121		114		98	
Personeli administrativ	27		28		28	
Gjithsej	148 ¹⁰	140	142	136	126	124

PROCESET E REKRUTIMIT

Gjatë vitit 2013 ne kemi realizuar tre procese rekrutimi, njëri kishte të bëjë me rekrutimin e përkthyesve të përkohshëm, njëri për një përkthyes të përhershëm, shqip-serbisht, dhe një për pozitën e asistentit në zyrën e Burimeve Njerëzore. Angazhimi i përkthyesve të përkohshëm gjatë kulmit të sezonit, duke pasur parasysh ngarkesën e punës, është kthyer në një domosdoshmëri. Ne kemi angazhuar katër përkthyes për një periudhë të caktuar nëpërmjet kontratave për shërbime të veçanta. Procesi i rekrutimit të auditorëve të rinj ka nisur në fund të vitit 2012, ndërsa punën kanë filluar në janar të vitit 2013.

Ne kemi procese rekrutimi transparente dhe gjithmonë i përgjigjemi menjëherë aplikuesve rreth informacioneve që ata kërkojnë. Megjithatë, një kandidat vendosi të paraqesë një ankesë në Bordin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, por kërkesa e tij u hodh poshtë, në favor të ZAP-it.

TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI

Të kesh staf dhe menaxherë të aftë, të zotuar, komunikues, të dhembshur, konkurrues, guximtarë, dhe kureshtarë është një parakusht që të mund të kryesh një auditim efektiv dhe për mbështetje në auditim. Prandaj, ne jemi fokusuar në zhvillimin e stafit, menaxherëve, proceseve të punës, dhe sistemeve tona.

Gjatë vitit 2013, ne kemi organizuar një numër të konsiderueshëm të trajnimeve të brendshme (50), gjatë 38 ditëve të punës me mbi 3,000 orë trajnim të brendshëm. Trajnimet janë ofruar edhe nga partnerët e Projektit të Binjakëzimit dhe nga Zyra Kombëtare Suedeze e Auditimit. Kjo e fundit

⁸ Gjatë vitit 2008, ne kemi aplikuar një sistem rrotacioni për Udhëheqësit e Ekipëve.

⁹ Dy kanë dhënë dorëheqje dhe një ka vdekur

¹⁰ Numri i pozitive në fund të vitit ishte 148. Numri është më i lartë se sa pozitat e aprovuar si rrjedhojë e rekrutimit të vendësuesve të personelit në pushim lehonie.

kryesisht ofroi asistencë në auditimin e performancës derisa Projekti i Binjakëzimit u fokusua tek auditimi i rregullsisë.

Pjesëmarrja në trajnimet e jashtme përfshinte seminare, punëtori dhe konferencat duke marrë mbi 1,500h efektive. Shembull i kësaj është trajnimi dhe certifikimi i një numri të punonjësve në modulën Qeverisja, Rreziku dhe Kontrolli organizuar nga CIPFA. Me interes të veçantë është edhe fakti se pjesa më e madhe e menaxherëve kanë marrë pjesë në një program certifikimi dhe janë certifikuar si menaxherë të cilësisë, e cila lidhet me standardin ISO 9001 (UBT).

Përveç kësaj, stafi ka marrë pjesë në skemën e certifikimit nga SHKÇAK. Gjithsej 102 punonjës ndoqën modulet e ndryshme në mbi 5,000 orë ligjërata. 155 iu nënshtruan provimeve ku 57 prej tyre, apo 36.8%, kaluan me sukses. Bazuar në këtë, tre punonjës ia dolën të përfundojnë nivelin e certifikimit, pesë kaluan nga niveli i dytë në të tretin dhe pesë të tjerë përfunduan me sukses nivelin e dytë të skemës së certifikimit të SHKÇAK për auditorë të sektorit privat

Tabela 8: Gradat/kualifikimet e personelit

Kategoria	2013	2012	2011
Auditor i Certifikuar	28	25	24
Kontabilist i Certifikuar	31	29	27
Teknik i Kontabilitetit	24	28	20
Auditor në Trajnim	23	14	21
Auditorë të Performancës	11	8	4
Auditor i Brendshëm	1	1	1
Gjithsej	119	106	97

Stafi jonë nga komuniteti serb vazhdon të marrë pjesë në skemën e certifikimit të ofruar nga Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve e Serbisë.

Ne kemi ofruar gjithsej 10,000 orë trajnime si brenda ashtu edhe jashtë zyrës. Ne gjithashtu kemi stimuluar stafin për t'u përgatitur për provime.

Veç kësaj, ne kemi ofruar programe për praktike për studentët. Kjo është bërë në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin 'Hasan Prishtina'.

Ne jemi të përkushtuar ta ndjekim shtegtimin tonë drejt suksesit duke ofruar edhe më shumë mundësi zhvillimi për punonjësit tanë. Synimi ynë strategjik është profesionalizmi, dhe ne do të vazhdojmë të investojmë në edukimin e personelit që ata të certifikohen dhe kualifikohen dhe të bëhen më kompetentë për kryerjen e punës së tyre.

PROGRAMI I RI I CERTIFIKIMIT PËR AUDITORËT E RREGULLSISË

Në Shtator të vitit 2013 ne kemi lansuar programin e ri për certifikimin e auditorëve të rregullsisë për sektorin publik, i pari i këtij lloji në kontekst më të gjerë rajonal. Programi bazohet në Standardet Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit (SNISA) dhe është hartuar në mënyrë të atillë që ti përshtatet kontekstit të administratës publike të Kosovës. Ai përfshin fazat në vijim:

- Faza hyrëse;
- Faza përgatitore;
- Faza formale e certifikimit; dhe
- Faza e edukimit të vazhdueshëm profesional (EVP).

Faza hyrëse dhe ajo përgatitore kryhen zakonisht brenda, ndërsa EVP zhvillohet në bashkëpunim me SHKÇAK dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore.

SHKÇAK është kontraktuar për ofrimin e certifikimit formal. Është e rëndësishme për ne që trajnimi dhe provimet të kryhen jashtë zyrës në një shoqatë profesionale të ankoruar në auditimin në sektorin privat, cilësia e së cilës është vlerësuar nga një shoqatë ndërkombëtare (IFAC). Në këtë mënyrë, ne përdorim sa më mirë që është e mundur burimet e mangëta dhe zvogëlojmë rrezikun për nepotizëm. Skema e Certifikimit përbëhet nga tre nivele ku përfshihen tetë provime.

TABELA 9: SKEMA E RE E CERTIFIKIMIT PËR SEKTORIN PUBLIK: MODULET E NDRYSHME

SKEMA E CERTIFIKIMIT PËR SEKTORIN PUBLIK		
Auditor i Sektorit Publik (PS/A)	Auditor i Lartë i Sektorit Publik (PS/SA)	Auditor i Certifikuar i Sektorit Publik (PS/CA)
M1. Raportimi Financiar M2. Planifikimi dhe Buxhetimi M3. Ligjet Nacionale (Moduli Ligjor)	M4. Procedurat dhe Teknikat e Menaxhimit të Financave Publike në Kosovë M5. Qeverisja, Rreziku dhe Kontrolli M6. Metodologjia e Auditimit I	M7. Metodologjia e Auditimit II M8. Menaxhimi Financiar

Në kuadër të skemës së re janë organizuar pesë module trajnimi që nga Shtatori 2013, përfshirë provimet. Në tërësi, 106 kandidatë iu nënshtruan 163 provimeve. Një numër modulesh të reja kanë filluar gjatë vitit 2014. Rezultatet e vitit të parë të zbatimit të skemës së certifikimit do të vlerësohen në korrik 2014.

Po për të njëjtin qëllim, ne jemi duke punuar drejt themelimit të një programi certifikimi për auditorët e performancës. Disa nga modulet në skemën e certifikimit për auditorët e certifikimit do të jenë pjesë e këtij programi.

SINDIKATA E PUNËTORËVE

Në vitin 2012 stafi i zyrës kanë themeluar sindikatën e tyre (SP/ZAP), të cilës i është dhënë mbështetje nga partnerët tanë ndërkombëtarë. Një kornizë për përcaktimin e roleve, përgjegjësi, qasjeve, dhe punëve praktike është duke u hartuar në kontekst të mbështetjes së anëtarëve por edhe të interesit të përbashkët të institucionit tonë. Ekziston një numër masash që mund të merren për të rritur pozitën ekzistuese, të cilat do të ndajnë qartë fushat e veçanta të aktivitetit dhe rolet e përgjegjësitë e ndryshme të sindikatës dhe menaxhmentit.

3.4 REKOMANDIMET NGA AUDITORËT E JASHTËM

Kuvendi ka emëruar një firmë private të auditimit për të audituar Pasqyrat tona Vjetore Financiare të vitit 2013. Auditorët kanë dhënë opinion të pa-modifikuar, që do të thotë se pasqyrat në të gjitha aspektet materiale janë prezantuar drejtë (shih Shtojcën III).

Në Letër Rekomandimin për Menaxhmentin auditorët kanë thënë se nuk kanë vërejtur çështje që përfshinë kontrollin e brendshëm dhe operacionet që konsiderohen të kenë dobësi material. Auditorët, gjithsesi, kanë vërejtur çështje tjera që ndërlidhen me strukturën e kontrollit të brendshëm dhe çështjet tjera të kontabilitetit apo operacionale, që janë të prezantuara në letër. Letër Rekomandimi për Menaxhmentin është dorëzuar në Kuvend. gjithashtu edhe në zyrën tonë.


4. BASHKËPUNIMI

Ne konsiderojmë se forcimi i bashkëpunimit me partnerët në Kosovë dhe ato ndërkombëtarë, kontribuon më tej në përmirësimin e cilësisë dhe ndikimit të punës tonë në promovimin e llogaridhënies për menaxhimin e fondeve publike.

Marrëdhëniet tona me Parlamentin dhe komisionet e tij, veçanërisht Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike janë të një rëndësie të madhe. Në vitin 2013, KMFP ka organizuar seanca dëgjimore me 17 entitete të audituara nga ne, ku u diskutuan raportet tona të auditimit. Për më tepër, ne kemi filluar të hartojmë përmbledhje të shkurtra për anëtarët e KMFP-së në mënyrë që të kontribuojmë për një proces llogaridhënieje më të informuar në diskutimet e tyre.

Ne kemi ruajtur gjithashtu edhe bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë, veçanërisht me Ministrinë e Financave, me qëllim të ofrimit të mbështetjes tonë në ndërtimin e qeverisjes së mirë të proceseve të Menaxhimit të Financave Publike në Kosovë. Në shumë raste ne kemi shërbyer si një lehtësues i proceseve dhe ka ndihmuar për sa i përket koordinimit, në mënyrë që të maksimizohet ndikimi i përpjekjeve të MFP-së në Kosovë.

Ne kemi vazhduar t'i ofrojmë mbështetje autoriteteve hetimore dhe autoriteteve të drejtësisë në përpjekjet e tyre për të siguruar përdorimin e duhur të parave të taksapaguesve.



Presidenti i Shqipërisë, Z. Bujar Nishani, dekoron Auditorin e Përgjithshëm me "Medaljen e Mirënjohjes".

4.1 PROJEKTET

Partnerët tanë ndërkombëtarë, të cilët na mbështesin në projekte afatgjata, janë duke na ndihmuar për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Korporativ dhe duke na ushqyer një kulturë të orientuar nga rezultatet. Me ndihmën e tyre, ne duam të zgjerojmë fushat dhe temat e auditimit, të përmirësojmë cilësinë dhe të rrisim aftësinë për t'iu përgjigjur nevojave të Parlamentit dhe publikut.

Partnerët tanë në projektin e binjakëzimit kanë vazhduar të ofrojnë mbështetjen e tyre në auditimin statutor. Bazuar në përvojën e tyre, ne jemi duke punuar në përmirësimin e Sistemeve të Menaxhimit të Cilësisë në auditimin e rregullsisë. Bashkëpunimi i binjakëzimit është më i gjerë se kaq, ai mbulon një numër fushash të rëndësishme për sukses siç janë menaxhimi dhe planifikimi.

Bashkëpunimi dypalësh me Zyrën Suedeze të Auditimit po vazhdon. Përveç angazhimit të drejtpërdrejtë në zhvillimin e aftësive për metodat e auditimit të performancës, projekti është përqendruar edhe për të na ofruar mbështetje për zhvillimin e një skeme trajnimi dhe certifikimi, e cila do të përcaktonte themelet e forta të auditimit të performancës/jo-statutor si dhe do të hidhte për një zhvillim të qëndrueshëm të auditimit të performancës.

Përveç mbështetjes së drejtpërdrejtë, partnerët tanë suedezë kanë lehtësuar bashkëpunimin tonë me ISA-të e tjera në rajon për planifikimin e auditimeve paralele me interes të përbashkët. Ne kemi nisur tashmë bashkëpunimin e parë të kësaj natyre me një temë të re të auditimit të performancës rreth 'Sigurisë në rrugë'.

Projekti më i ri mbështetës, i financuar nga Banka Botërore, ka filluar në tetor 2013 dhe ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të disa auditorëve për të analizuar në mënyrë kritike sistemet e prokurimit dhe efikasitetin e përdorimit të burimeve publike.



Konferenca e Pestë Vjetore e ZAP

4.2 PUNA NË RRJET

Në 2013 kemi marrë pjesë edhe në një numër forumesh ndërkombëtare, të cilat ne i konsiderojmë si një promovim të rëndësishëm për ZAP-in në veçanti dhe shtetin e Kosovës në përgjithësi. Edhe pse ende jo anëtare e INTOSAI-t, ne për herë të parë kemi marrë pjesë në një takim përparimor për kongresin e ardhshëm të EUROSAI-t si dhe në një takim të rrjetit të Gjykatës Evropiane të Auditorëve dhe Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve aplikante dhe vendeve aplikante të mundshme, si të barabartë në mesin e të barabartëve.

Auditori i Përgjithshëm ka marrë pjesë në një takim të Komitetit Drejtues të MOSAIC¹¹ në Kinë, ku ka paraqitur dhe diskutuar përvojat e fituara nga dizajnimi dhe përdorimi i programeve për certifikimin e auditorëve për sektorin publik.

Puna në rrjet dhe promovimi i mëtejshëm i ZAP-it ka filluar përmes auditimeve paralele të performancës me vendet e tjera të rajonit, të cilat do të mbështeten nga BE-ja dhe nga ISA-të e mirë-zhvilluara të Evropës Perëndimore.

Përveç kësaj, ne kemi një bashkëpunim të veçantë me Institucionin Suprem të Auditimit të Shqipërisë në mënyrë që të përdorim burimet e mangëta në mënyrë efektive.

4.3 AUDITIMET E FONDEVE TË DONATORËVE

Gjatë vitit 2013 kemi pasur edhe diskutime me donatorët ndërkombëtarë për planifikimin dhe kryerjen e auditimeve të fondeve të donatorëve në mënyrë që të ofrojmë garanci për përdorimin e këtyre fondeve. Kryerja e këtyre auditimeve, përveç që sjellë të ardhura në buxhetin e Kosovës, ofron edhe siguri se puna e kryer nga ne është e një cilësie të lartë dhe hap rrugën për mbështetje buxhetore të drejtpërdrejtë.



Kongresi EUROSAI për të rinj

¹¹ MOSAIC është një memorandum mirëkuptimi i cili përcakton bazat për përmirësimin bashkëpunimor mes IFAC, donatorëve ndërkombëtarë, dhe komunitetit ndërkombëtar për zhvillim

5. FOKUSI I ARDHSHËM

Viteve të fundit, përkundër sfidave që kemi hasur, ne kemi treguar edhe zhvillime të shumta pozitive. Mandati i Auditorit të Përgjithshëm përfundon në fund të muajit gusht 2014 dhe zbatimi i strategjisë së tij dalëse paraqet sfida të veçanta për ne në sigurimin e qëndrueshmërisë dhe aftësisë për të menaxhuar ndryshimet. Synimet tona strategjike janë ambicioze dhe janë të orientuara drejt ndryshimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së përgjithshme.

Në kontekst të kësaj, gjatë shtatorit 2013, ne kemi filluar me azhurnimin e Strategjisë për Zhvillim Korporativ. Kjo Strategji do të mbulojë periudhën kohore 2014-2020 dhe do të jetë e përafuar me perspektivën në planin për integrimin Evropian.

Duke u bazuar në analizën e pikave të forta dhe të dobëta të organizatës, si dhe duke pasur parasysh mundësitë dhe rreziqet potenciale, strategjia do të diskutohet dhe mbështetet gjerësisht nga një plan veprimi për implementim dhe një kornizë për menaxhimin e rrezikut. Objektivi jonë është që të krijojmë një proces të qëndrueshëm të planifikimit të përbashkët dhe, për të monitoruar zbatimin e planit të veprimit është themeluar një grup pune.

Siç është thënë edhe në raportin e vitit të kaluar, për të ekzekutuar mandatin tonë ne planifikojmë, në periudhën afatmesme, të përmbushim objektivat e mëposhtme:

- Sigurimi i pronësisë vendore dhe qëndrueshmëria institucionale;
- Kontribuimi në forcimin e qeverisjes së mirë; dhe
- Zhvillimi dhe ruajtja e cilësisë së organizatës dhe auditimit.

Për të siguruar pronësinë vendore dhe qëndrueshmërinë institucionale ne planifikojmë masat e mëposhtme:

- Mbështetja për të pasur sa më parë Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, në pajtim me standardet e auditimit në sektorin publik të njohura ndërkombëtarisht;
- Hartimi i akteve të brendshme në lidhje me ligjin e ri dhe zbatimi i tyre;
- Miratimi i Strategjisë për Zhvillim Korporativ deri në Shtator të vitit 2014;
- Thellimi i mëtejshëm i marrëdhënieve afatgjata dhe mirëfunksionuese me partnerët tanë;
- Sigurimi i zbatimit të një kulture të orientuar në rezultate dhe përmbushja e objektivave operative dhe administrative përmes punëtorëve profesional, etik dhe të motivuar në të gjitha nivelet;
- Zhvillimi i dialogut social me Sindikatën e organizatës, në pajtim me praktikën e mira Evropiane;
- Zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit rajonal me organizatat simotra dhe një nivel më i lartë i pjesëmarrjes në rrjetet profesionale ndërkombëtare; dhe
- Forcimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të brendshme organizative

Me qëllim që të kontribuojmë në forcimin e qeverisjes së mirë duhet të kryehen veprimet në vijim:


- Konsolidimi i cilësisë së auditimit statutor dhe forcimi i auditimit jo-statutor;
- Marrja përsipër e më shumë auditimeve të fondeve të donatorëve;
- Investimi i burimeve për ngritjen e vetëdijesimit dhe njohuri të zgjeruara në lidhje me pasojat për Menaxhimin e Financave Publike pas ndjekjes së ambicieve për tu integruar më tej në BE;
- Zhvillimi i mëtejshëm i auditimit të sistemeve të TI-së;

- Hartimi me kohë dhe rritja e cilësisë së RVA-së dhe raporteve individuale sipas organizatave buxhetore;
- Zhvillimi i mbështetjes së mëtutjeshme për funksionin e mbikëqyrjes parlamentare, në veçanti KMFP, për të forcuar llogaridhënien e personave të ngarkuar me qeverisje;
- Zhvillimi i bashkëpunimit me ekzekutivin në fushën e reformës në administratën publike; dhe
- Thellimi i bashkëpunimit dhe komunikimit të jashtëm me shoqërinë civile, mediat dhe projektet.

Me qëllim që të zhvillojmë dhe ruajmë cilësinë ne planifikojmë të kryejmë veprimet e mëposhtme:

- Forcimi i mëtutjeshëm i funksionit të cilësisë;
- Implementimi i plotë i programit të ri të certifikimit;
- Përgatitja e programit të certifikimit për auditorët e performancës;
- Ngritja e efikasitetit në auditim përmes zgjidhjeve të reja të TI-së; dhe
- Futja në përdorim e veglave më të mira menaxheriale dhe administrative.

Dëshirojmë të theksojmë faktin se që nga themelimi, ZAP ka operuar në lokalet e marra me qira, për çka janë shpenzuar shuma të konsiderueshme parash nga BK-ja. Ne kemi ka një kontratë qiraje deri në Gusht të vitit 2014. Qeveria e Kosovës duhet të analizojë mundësitë për të na ofruar ZAP-it akomodim të mjaftueshëm në ndërtesa publike në mënyrë që të zvogëlohen kostot e përgjithshme.



6. LLOGARIDHËNIA E ZAP

Sigurimi i integritetit

Përmes kësaj, garantoj se informacioni në Raportin Vjetor të Performancës, përfshirë edhe pasqyrat financiare, janë të sakta, të besueshme, dhe objektive.



Lars Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm

Deklarata e Transparencës

Përmes kësaj, garantojmë se puna jonë gjatë vitit 2013 është kryer në pajtim me Statutin e Shërbimit Civil dhe Kodin e mirësjelljes së ZAP-it



Artan Venhari, Zëvendës Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Asistent Auditor i Përgjithshëm;



Ibrahim Gjylderen, Asistent Auditor i Përgjithshëm;



Ilire Daija-Buza, Shefe e Kabinetit të AP/MP

SHTOJCAT

SHTOJCA 1: PARATHËNIE E SHKURTËR PËR ZAP

ROLI

Auditori i Përgjithshëm është institucion kushtetues i pavarur dhe i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit. ZAP ndihmon Auditorin e Përgjithshëm, mandati dhe detyrat e të cilit janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrës së Auditimit në Kosovë. Auditori i Përgjithshëm aktual u emërua në fillim të vitit 2009 nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN). Mandati i tij do të përfundojë në Gusht 2014.

Në ushtrimin dhe përmbushjen e detyrimeve të tij për arritjen e objektivave, Auditori i Përgjithshëm gëzon liri të plotë të ndërmarrë veprimet e duhura në funksion të mandatit të tij. Ai përgjigjet vetëm para Kuvendit.

Ruajtja e objektivitetit dhe pavarësisë tonë nga organizatat të cilat i auditojmë është vendimtare. Objektiviteti dhe pavarësia duhet të sigurohen me anë të zbatimit të mirë të një mandati të gjerë, të qëndrueshëm, dhe ligjor; pajtueshmërisë me standardet e auditimit në sektorin publik të pranuar ndërkombëtarisht, dhe një kodi të brendshëm për mirësjelljen profesionale.

AKTIVITETI JONË

Ne kryejmë Auditimet e Rregullsisë të Buxhetit të Kosovës dhe të gjitha organizatave buxhetore në bazë vjetore, ku përfshihen Kuvendi, Zyra e Presidentit, çdo ministri dhe agjenci ekzekutive, komunat, organet e pavarura dhe entitete të tjera.

Ne gjithashtu kryejmë Auditime të Performancës. Kjo është në fushëveprimin tonë, por nuk është një kërkesë vjetore e parashikuar me ligj. Këto auditime do të kryhen në mënyrë që të vlerësojmë nëse programet qeveritare janë duke u menaxhuar si duhet, ekonomikisht, dhe në mënyrë efikase, dhe nëse janë vendosur masa për matjen dhe raportimin e efikasitetit të tyre.

Ne raportojmë për auditimet tona tek entitetet e audituara dhe Kuvendi (KMFP) dhe këto raporte do të publikohen. Raportet tona do të përmbajnë rekomandime me qëllimin për të nxitur ndryshim dhe praktika më të mira. Me këtë duam t'i ofrojmë Kuvendit, Qeverisë, dhe Taksapaguesve një shërbim auditimi profesional të bazuar në fakte dhe të integruar.

Me qëllim që të ndihmojmë në zbatimin, zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e Menaxhimit të Financave Publike, ne do të sigurojmë tatimpaguesit dhe donatorët ndërkombëtar se burimet publike përdoren në mënyrë ekonomike, efektive dhe efikase. Ne e bëjmë këtë duke siguruar se fondet publike raportohen, administrohen dhe përdoren në mënyrën e duhur dhe me maturi.

PROCESI I LLOGARIDHËNIES

Pasqyrat tona Vjetore Financiare (PVF) përgatiten sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Ato janë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik mbi Bazat e Parasë së Gatshme dhe modifikimet e aplikueshme sipas vendimit të Qeverisë. Për të na mundësuar të dëshmojmë përgjegjshmërinë dhe objektivitetin tonë, Kuvendi çdo vit duhet të emërojë një auditor të jashtëm për të bërë auditimin e Pasqyrave tona Vjetore Financiare.

Kuvendi cakton auditorët e jashtëm për ne. Opinioni i auditimit mbi PVF-të e vitit 2013 është përfshirë në Raportin Vjetor të Performancës, së bashku me PVF-të. Në letrën e auditorëve të jashtëm drejtuar menaxhmentit janë përfshirë shkurtimisht rekomandimet si dhe komentet tona ndaj tyre. Në këtë mënyrë ne ua mundësojmë lexuesve të kenë një pamje, pas auditimit, rreth mënyrës se si i kemi përdorur burimet që na janë dhënë dhe rezultatet nga kjo. Raportet janë të publikuara në faqen tonë të internetit¹².

Përpos auditimeve të jashtme, edhe auditimet e brendshme të kryera nga njësia për auditim të brendshëm sigurojnë Auditorin e Përgjithshëm që Zyra vepron në pajtueshmëri me ligjet dhe politikat e veta.

KUSH DO T'I VLERËSOJË METODOLOGJITË TONA TË AUDITIMIT?

Ne kemi bërë shumë për të siguruar që të ndjekim praktikën dhe metodologjinë e mira të auditimit. Ne jemi duke zbatuar një kornizë të menaxhimit të cilësisë. Metodologjinë e mira dhe korniza e cilësisë sigurojnë që auditimet tona kryhen në pajtim me standardet¹³ e themeluara të praktikës profesionale.

Ne ndjekim sistemin e rregullt ndërkombëtar të kontrolleve mbi punën tonë të auditimit; auditimet tona ekzistojnë brenda një kornize rigoroze të standardeve të auditimit, të cilën stafi mëson se si ta përdorë gjatë programit tonë të trajnimit. Pastaj, gjatë një procesi qartësimi, diskutohet me entitetet e audituara për të gjeturat e auditimit. Në sistemin tonë është ndërtuar rishikimi nga ana e menaxhmentit dhe monitorimi i mëtejshëm bëhet nga një funksion i veçantë në kuadër të Zyrës. Pas kësaj, raportet tona publikohen dhe janë të hapura për ekzaminim. Pastaj fillojnë shqyrtimet dhe diskutimet në Kuvend së bashku me Ekzekutivin rreth rekomandimeve të auditimit.

KUSH DO TË RISHIKOJË FINANCIMIN TONË?


Si Auditor i Përgjithshëm, unë – përveç këtij Raporti Vjetor të Performancës që fokusohet në mënyrën se si është shpenzuar buxheti i Zyrës së Auditimit – do të përgatis dhe dorëzoj çdo vit në Kuvend kërkesat buxhetore. KMFP dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa mund të më drejtohen mua për të shpjeguar kërkesën buxhetore për Zyrën dhe për të diskutuar raportin tonë mbi planet dhe prioritetet, objektivat e performancës, raportin tonë vjetor të performancës, dhe praktikën tonë të menaxhimit.

¹² www.oag-rks.org

¹³ ISSAI, International Standards of Supreme Audit Institutions, përcaktojnë parakushtet themelore për funksionimin e duhur dhe sjelljen profesionale të institucioneve të tilla: www.issai.org

Qeveria e inkorporon kërkesën time buxhetore në Buxhetin e propozuar të Kosovës dhe mund të japë komente për të në një dokument të veçantë. Buxheti i Zyrës do të aprovohet nga Kuvendi.

ORGANIZIMI I ZAP PËR 2013/14



SHTOJCA 2: PASQYRAT VJETORE FINANCIARE DHE ADRESIMI I REKOMANDIMEVE PËR VITIN 2012

Pasqyra financiare 1.

1

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2013

Shenime shpjeguese		2013		2012		2011	
		Llogaria e Vetme e Thesarit BK	Pagesat nga palet e treta	Llogaria e Vetme e Thesarit BK	Llogaria e Vetme e Thesarit BK	Llogaria e Vetme e Thesarit BK	Llogaria e Vetme e Thesarit BK
		€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
BURIMET E FONDEVE							
Granti Qeveritar	1	1,905		1,815		1,728	
Grantet e përcaktuara të donatorëve	2	21	7*	7			
Totali i Pranimeve		2,006	7	1,822		1,728	
SHFRYTËZIMI I FONDEVE							
Operacionet							
Pagat dhe Meditjet	3	1,268		1,174		1,037	
Mallrat dhe Sherbimet	4	614	7	561		574	
Sherbimet Komunale	5	29		32		35	
		1,911	7	1,767		1,646	
Transferet dhe Subvencionet	6	75		-		60	
Shpenzimet Kapitale	7	20		55		22	
		95	-	55		82	
Totali i Pagesave		2,006	7	1,822		1,728	

* Ky shpenzim është administruar nga Projekti i Birjakëzimit i financuar nga BE-ja dhe si i tillë nuk ka kaluar nëpër Llogarinë e vetme të Thesarit, gjegjësisht SIMFK.

Pasqyra financiare 2.

2

Pasqyra e realizimit të buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore aktuale për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2013

Shenime shpjeguese		2013				2012	2011
		Buxheti fillestar (Ndarja) A	Buxheti Final (Ndarja) B	Aktuali C	Variance D=C-B	Realizimi E	Realizimi F
		€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Hyrja e parase së gatshme në llogari të Thesarit							
Donacionet	8	-	51	21	(29)	7	
Pranimet totale të mbledhura për BK-në		-	51	21	(29)	7	-
Daljet e parase së gatshme nga llogaritë e thesarit							
Pagat dhe meditjet	9	1,305	1,285	1,268	(17)	1,174	1,037
Mallrat dhe Sherbimet	10	620	666	614	(52)	561	574
Sherbimet komunale		45	45	29	(16)	32	35
Transferet dhe Subvencionet	11	100	75	75	-	0	60
Shpenzimet kapitale	12	50	50	20	(30)	55	22
Totali i pagesave i bërë nga BK përmes LiVTh		2,120	2,121	2,006	(115)	1,822	1,728

BURIMI I FONDEVE**Shënimi shpjegues 1. Ndarjet e fondit të përgjithshëm**

Klasifikimi ekonomik	Shënime	2013	2012	2011
		BK € '000	BK € '000	BK € '000
Pagat dhe mëditjet		1,268	1,174	1,037
Mallrat dhe shërbimet		593	554	574
Shërbimet komunale		29	32	35
Subvencionet dhe transferet		75	-	60
Shpenzimet kapitale		20	55	22
Totali		1,985	1,815	1,728

Shënimi shpjegues 2. Grantet e përcaktuara të donatorëve

Klasifikimi ekonomik	Shënime	2,013	2012	2011
		BK € '000	BK € '000	BK € '000
Mallrat dhe Shërbimet		21	7	-
Totali	2.1	21	7	-

2.1. Nga kjo shumë:

- a) 7,000€ paraqesin donacionin nga ZKA e Suedisë për të bashkefinancuar konferencën e peste vjetore të ZAP të mbajtur nga 03-05, Korrik në Oher; dhe
 b) 14,268€ paraqesin donacionin nga Ambasada e BeM në Prishtinë për trajnim të trajnerëve të ardhshëm në modulën "Qeverisje e Mirë dhe Kontrolli". Këtë trajnim e kanë ndjekur: 15 zyrtarë të ZAP dhe të gjithë janë certifikuar, 2 zyrtar nga SHKÇAK si dhe 2 zyrtar nga KLSH.

SHFRYTËZIMI I FONDEVE**Shënimi shpjegues 3. Pagat dhe mëditjet**

4

Përshkrimi	Shënime	2013	2012	2011
		BK € '000	BK € '000	BK € '000
Pagesat nga BK				
Neto pagat		1,066	908	876
Tatimi mbi të hyrat personale		77	71	63
Pagesa e kontributit pensional nga punëdhënësi		60	56	49
Pagesa e kontributit pensional nga i punësuar		60	56	49
Pagesat për Sindikata		5	3	0
Totali	3.1	1,268	1,174	1,037

3.1 Nga kjo shumë e përgjithshme 54% përbejnë koeficientet, 30% shtesat e parapara me Ligjin për shërbyesit civil dhe 16% taksa dhe kontribute pensionale.

Shënimi shpjegues 4. Mallrat dhe shërbimet

Përshkrimi	2013		2012		2011	
	Shënime	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Pagesat nga BK						
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit	4.1	33	30	24		
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	4.2	31	21	12		
Internet		3	3	3		
Shpenzimet tjera telefonike /z.mobile	4.3	23	20	16		
Shpenzimet postare		1	1	0		
Sherbimet e arsimit dhe trajnimit	4.4	108	36	32		
Sherb e ndr.intelektuale këshilldhënëse	4.5	57	77	102		
Sherb kontraktuale tjera	4.6	23	8	18		
Sherbime teknike		1	2	1		
Shpenzimet për anëtarësim		1	1	2		
Mobiljet dhe pajisjet(më pak se 1000)	4.7	2	10	9		
Telefona (më pak se 1000€)	4.8	0	3	10		
Kompjutere (me pak se 1000€)	4.9		26	27		
Hardwer për TI <1000	4.10.	0	5	1		
Pajisje tjera <1000€	4.11.	2	15	5		
Furnizime për zyrë	4.12.	25	12	20		
Furnizime ushqim dhe pije	4.13.	12	17	4		
Furnizime pastrimi		2	3	5		
Furnizime veshmbathje		1		1		
Akomodimi		5	5			
Vaj për ngrohje	4.14.	12	6	16		
Derivate për gjenerator		0	1	2		
Karburant për vetura	4.15.	11	8	7		
Regjistrimi i automjeteve		1	0	1		
Sigurimi i automjeteve		5	5	6		
Taksa komunale		0	0	0		
Sigurimi i ndërtesave dhe tjera		13	12	13		
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	4.16.	13	6	4		
Mirëmbajtja e ndërtesave		13	15	14		
Mirëmbajtja e tekn.informative		14	12	6		
Mirëmb.e mobileve dhe pajisjeve		1	2	1		
Qiraja për ndërtesa		168	168	168		
Qiraja-pajisje	4.17.	19	16	15		
qiraja përdorime tjera të hapësirave		1				
Reklamat dhe konkurset		1	3	3		
Sherbime shtypje -jo marketing		9	10	10		
Informimi i publik		0	1	9		
Drekat zyrtare	4.18.	3	1	7		
Totali:		614	561	574		

Shënime:

- 4.1 Këto shpenzime reflektojnë punën e ekipeve të auditimit në terren - akomodimi në hotele gjatë auditimit të Komunave të cilat janë më shumë se 50 km larg Prishtinës. Diferenca në mes të shpenzimeve të vitit 2012 dhe 2013 ka të bëjë me rritjen e numrit të komunave të audituara nga stafi ynë e që ndikon në shtimin e numrit të ekipeve të auditimit për këto komuna.
- 4.2 Zgjerimi i bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar është pjesë e portfolios tonë dhe kjo reflekton në ngritje të shpenzimeve në vitin 2013. Mjetet e shpenzuara ndërlidhen me pjesëmarrje të stafit në punëtorë; konferenca jashtë Kosovës dhe shpenzimet e përdorura për auditim të ambasadaeve.
- 4.3 Shpenzimet e rritura kur krahasojmë me vitin 2012 janë për shkak të numrit të shtuar të stafit tonë. Bazuar në politiken tonë të brendshme për përdorim të shërbimeve të telefonise mobile **€6,306** janë rimbursuar në buxhetin e ZAP - kategoria Paga dhe Meditje. Kjo tregon se zyria kishte 16,984€ shpenzime në këtë kategori. Përveç kesaj, kostot për përdorim të telefonise fikse po reduktohen (shih shënimin 5.1)
- 4.4 Kjo shumë paraqet shpenzimet për pagesën e trajnimeve të mbajtura për auditorët. Shpenzimet më të larta krahasuar me vitin 2012 janë për shkak të implementimit të skemes së re të certifikimit të sektorit publik për auditor të rregullsisë (mbi 100 auditorë), 90,086€ ndërlidhen me kostot për certifikimin e auditoreve. Marreveshja për implementimin e kesaj skeme është nënshkruar në korrik të vitit 2013. Mjetet shtesa për mbulimin e shpenzimeve në këtë kod ekonomik nga ato të planifikuara janë siguruar përmes shkurtimeve të bëra në kodet tjera në kuadër të kesaj kategorie ekonomike (shërbimet intelektuale dhe këshilluese; kompjutor; pajisjet tjera dhe telefona). Përveç kesaj, kjo shumë përfshin edhe 14,268€ që është donacioni i dhënë nga Ambasada e BM në Prishtinë për të financuar projektin për trajnimin të trajnerëve të ZAP në modulën "Qeverisja e Mirë dhe Kontrolli" të mbajtur nga CIPF A-Angli.
- 4.5 Kjo shumë prezanton pagesën bërë kompanisë ndërkombëtare private të auditimit e kontraktuar për auditim të jashtëm të PVF-2012 të 11 komunave, si dhe për auditimin e ndërmjetëm për këto Komuna për vitin 2013. Numri i auditimeve të kontraktuara është më i ulët këtë vit krahasuar me vitin 2012 ishin të kontraktuara 18 Komuna, fakt ky që reflekton edhe me ulje të shpenzimeve në 2013. Në vitin 2012 për shkak të vonësavë në proces të prokurimit, auditimi i ndërmjetëm nuk është kryer fare.
- 4.6 Shpenzimet më të larta krahasuar me vitin 2012 janë për shkak të angazhimit me kontrata në vepër të: kater pastrueseve për një periudhë të caktuar kohore derisa është finalizuar kontrata e re për mirëmbajtje të objektit tone; kater perkthyesve për perkthimin e raporteve të auditimit gjatë sezonit të finalizimit të raporteve të auditimit si dhe angazhimin e kater auditoreve nga muaji gusht për një mbulim më të mirë të obligimeve tone në fushën e auditimit të komunave.Gjithashtu në këto shpenzime janë përfshirë edhe kostot për fotograf/kameraman për konferencën e poste vjetore.
- 4.7.Kjo shumë prezanton shpenzimet për furnizim me mobilje për stafin tonë. Për shkak se në procesin e rishikimit të buxhetit, nuk kemi marrë aprovimin për staf të ri siç është paraparë, nevoja për furnizim me mobilje të reja ishte më e ulët. Prandaj, këto shpenzime ishin më të ulëta krahasuar me vitin 2012.
- 4.8 Furnizimi me aparate telefonike për stafin tonë nuk është bërë për shkak të prioritetëve për implementimin e skemes së certifikimit në vitin 2013.
- 4.9 Një sasi e caktuar e mjeteve të planifikuara për blerje të Laptopëve për nevoja të stafit auditore janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve për skemen e re të certifikimit. Në të njëjtën kohë, disa Laptopë të nevojshëm kanë kushtuar më shumë se 1,000 dhe me rishikim të buxhetit janë planifikuar nga investimet kapitale. Megjithatë, kompania që kishte fituar kontratën ka deshtuar ti liferoj brenda vitit andaj i gjithë procesi ishte anuluar.
- 4.10. Në vitin 2013, kërkesat për furnizim me Hardwer për TI < 1000 ishin më të ulëta dhe kemi mundur ti menaxhojmë me para të imëta (petty cash).
- 4.11. Nuk kishte nevojë për investime të tjera në objektin që për momentin e kemi me qira.
- 4.12 Rritja e numrit të stafit ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve për furnizim me material për zyrë, gazeta ditore, biznes-karta për staf si dhe për dizajnim të dosjeve të cilat janë përdorur gjatë konferencës së poste vjetore. Rritja e shpenzimeve në këtë kod në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012 ndërlidhet me faktin se AQP është dazhur të filloj me procedura të centralizuar për këto zëra në fund të vitit 2012. Kjo nuk ka ndodhur. Në të njëjtën kohë, numri i stafit është rritur që ka ndikuar në rritje të shpenzimeve në këtë kategori.

4.13. Shpenzimet për këtë kategori kanë të bëjnë me konferencën tonë vjetore (6,370€); uje për pije përgjate vitit (1,140€) shpenzimet e mikëpritjes për ngjarje të ndryshme (4,944€) ZKA e Suedisë dhe projekti i binjakëzimit i financuar nga BE ka kontribuar për aktivitetet e konferencës tonë vjetore me nga 7,000€ secili përkatësisht 14,000€ në total. Si shkak i këtij bashkefinancimi kemi edhe këtë dallim në shpenzimet e bëra në 2013 dhe 2012. Shuma prej 7,000€ e bashkefinancuar nga projekti i binjakëzimit është prezantuar në Pasyqren e pranimeve dhe pagesave, në kolonën - Pagesat nga palet e treta.

4.14. Rezervat e vitit 2011 janë përdorur në vitin 2012. Në vitin 2013 është paraqitur nevoja për furnizim me vaj për ngrohje.

4.15. Shpenzimet për derivate janë rritur në krahasim me vitin 2012 për shkak të numrit të shtuar të ekipeve të auditimit në terren.

4.16. Në vitin 2013 është paraqitur nevoja për furnizim me goma për vetura zyrtare pasi janë konsumuar. Në të njëjtën kohë, nevoja për riparimin e veturave nga viti në vit është në rritje për shkak të vjetërsimit të tyre.

4.17. Ky shpenzim reflekton pagesën për softuerin e regjistrimit të kohës si dhe qirarë për fotokopjet e kontraktuara. Shpenzimet e rritura në vitin 2013 kanë të bëjnë me faktin që çmimi i qirarë për softuerin për regjistrim të kohës është më i lartë në 2013 krahasuar me 2012, si dhe vlera e kontratës për marrjen me qira të fotokopjeve, është më e lartë si shkak i kontraktimit të aparateve fotokopjuese me performancë më të avancuar.

4.18. Shpenzimet lidhur me viziten e delegacionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për ligjeratën e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm - afërsisht 30 zyrtarë me rastin e festimit të përvjetorit të V-të të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, si dhe shpenzimet e tjera të bëra me rastin e vizitave të delegacioneve të tjera bërë Institucionit tonë.

Shënimi shpjegues 5: Shërbimet komunale

7

Përshkrimi	Shënim	2013	2012	2011
		BK € '000	BK € '000	BK € '000
Rryma		18	19	16
Uji		2	1	2
Mbeturinat		1	1	1
PTK-fikse	5.1	8	11	16
Totali		29	32	35

Shënim:

5.1. Implementimi i pakos biznesore (shënim 4.3) të aranzhuar me kontratë ka rezultuar me zvogelim të nevojave për shfrytëzim të telefonisë fikse. Kjo ka rezultuar edhe me ulje të shpenzimeve përgjate tre viteve.

Shënimi shpjegues 6: Subvencione dhe transfere

	Shënim	2013	2012	2011
		BK € '000	BK € '000	BK € '000
Subvencione dhe transfere		75		60
Totali	6.1	75	-	60

6.1 Kjo shumë prezanton kontributin e ZAP bazuar në Marrëveshtjen e Qevensë së Kosovës dhe IMG për mbështetje të vazhdueshme të emëruarve të Përtqësuesve Civil Nderkombëtar, cilat emërimë janë vazhduar pas pavarësisë së mbikeqyrur. Kjo shumë mbulon kostot që përfundojnë në Gusht 2014.

Shënimi shpjegues 7: Shpenzime kapitale

8

Përshkrimi	Shënim	2013	2012	2011
		BK € '000	BK € '000	BK € '000
Blerja e licencave për softwerin IDEA				22
Blerja e serverëve			55	
Softuer për intranet		6		
Pajisje tjera (Skaner dhe fajlla metalik)		10		
Softuer për dizajnim të raporteve		4		
Totali		20	55	22

Shënimi shpjegues 8: Donacionet

Emri i Donatorit	Nr i projektit	Emri i projektit	2013 € '000
Donacioni nga Qeveria Britaneze	94426	Trajnimi "Qeverisja e mirë dhe kontrolli"	14
Donacioni nga Qeveria Suedeze	96207	Bashkefinancimi për konferencën e peste vjetore	7
Donacioni nga Banka Botërore	94134	Zhvillimi i aftësive për auditim të sistemeve prokuruese në Kosovë	29
Totali			51

Shënim:

Ne vitin 2013 janë pranuar tri donacione në vlerë prej €50,602. Nga kjo vlerë, shumë prej 7,000€ - donacioni i dhënë nga ZKA e Suedisë është shpenzuar për të bashkefinancuar konferencën e peste vjetore të ZAP të mbajtur nga 03-05, Korrik në Ohër; ndërsa shumë prej 14,268€ - donacioni i dhënë nga Ambasada e BeM në Prishtinë për trajnim të trajnerëve të ardhshëm në modulën "Qeverisje e Mirë dhe Kontrolli". Këtë trajnim e kanë ndjekur: 15 zyrtarë të ZAP dhe të gjithë janë certifikuar, 2 zyrtar nga SHKÇAK si dhe 2 zyrtar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit të Shqipërisë.

Donacioni i tretë është dhënë nga Banka Botërore për financimin e një programi që synon rritjen e zbatimit me të mirë të Prokurimit Publik në Kosovë. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm mbështetet me një grant për një projekt 20 muajsh, i cili fokusohet drejt zhvillimit të aftësive profesionale në auditimin e sistemeve të prokurimit dhe marrjen e vendimeve të duhura afariste në prokurim. Ky projekt teknikisht administrohet nga Agjencioni Qendror i Prokurimit. Kësti i parë në vlerë prej 29,334€ është alokuar në buxhetin tonë, në fund të dhjetorit dhe ende nuk është shpenzuar.

Shënimi shpjegues 9: Paga dhe Mëditje

9

Buxheti i aprovuar për paga dhe mëditje për vitin 2013 ishte në vlerë prej 1,305,453€.

Me propozim nga zyra jonë dhe me vendim të Qeverisë së Kosovës nr.11/152, aprovohet kërkesa nga Ministria e Financave për reduktim të ndarjes buxhetore në këtë kategori ekonomike për vitin 2013 në vlerë totale prej €20,000 në emër të kursimeve buxhetore.

Niveli i realizimit të buxhetit është me i ulët nga ai i planifikuar, për arsye se parashikimet (niveli i kalueshmërisë së provimeve certifikuese si baze për rritjen e pagave, numri i parashikuar i pushimeve të lehonisë dhe zëvendësimet përkatëse, koha e rekrutimit të dy pozitave të lira) në të cilat është bazuar planifikimi fillestar kanë ndryshuar gjatë implementimit.

Shënimi shpjegues 10: Mallra dhe Shërbime

Buxheti i aprovuar për mallra dhe shërbime ishte në vlerë prej 620,000€.

Gjatë vitit 2013, buxheti në këtë kategori, në një anë është zvogëluar për 4,500€ me vendim të Qeverisë nr.11/152 në emër të kursimeve buxhetore ndërsa në anën tjetër është rritur nga donacionet e jashtme në vlerë prej **50,602€** (Shih shënimin shpjegues 4 - detajet se si janë përdorur këto fonde dhe 8 detajet për donacionet).

Shënimi shpjegues 11: Transfere dhe subvencione

Buxheti i aprovuar për transfere dhe subvencione për vitin 2013 ishte në vlerë prej 100,000€. Prej tyre, 25,500€ janë reduktuar me vendim të Qeverisë nr.11/152 në emër të kursimeve buxhetore, pas propozimit tonë. Ndërsa, pjesa e mbetur prej 74,500€ prezanton kontributin e ZAP bazuar në Marrëveshjen e Qeverisë së Kosovës dhe IMG për mbështetje të vazhdueshme të të emëruarve të Përfaqësuesve Civil Nderkombëtar për të cilët emërimet janë vazhduar pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrtur.

Shënimi shpjegues 12: Shpenzimet Kapitale

Gjatë procesit të ri shikimit të buxhetit për 2013, ZAP ka ri-destinuar tri projektet e mbetura duke i bartuar ato në vitin e ardhshëm. Nderkohë, janë paraparë tri projekte të tjera kapitale (furnizim me intranet, furnizim me kamerë profesionale si dhe furnizim me dy korniza digjitale).

Vonesat në aprovimin e Ligjit për ri-shikim të buxhetit për vitin 2013 e cila ka shkaktuar pengesa ligjore për fillim të procedurave të prokurimit, deshtimi i kompanisë së kontraktuar për liferim të 6 Laptopëve si dhe deshtimi tri herë i aktivitetit prokurues për furnizim me kamerë profesionale digjitale, për arsye të mos përmbushjes së specifikave teknike të përcaktuara me dosje tenderit, paraqesin faktorët kyç të cilët kanë ndikuar në nivelin e ulët të implementimit të projekteve kapitale të planifikuara me plan të prokurimit të vitit 2013.

Shpalosja e detyrimeve (Neni 15)**Detyrimet kontingjente**

Natyra e detyrimeve kontingjente	Shenim	2013	2012	2011
		€ '000	€ '000	€ '000
Qiraja		10	10	10
Totali	15.1	10	10	10

Shenim:

15.1 Shuma e prezantuar është një llogaritje e kompensimit eventual për riparime të ish-zyrës sonë që mund të kërkoheri nga pronari në bazë të padisë.

Shpalosja e pasurive (Neni 16)**16.a) Përmbledhje e pasurive jo-financiare (me vlerë mbi 1000€)****Klasifikimi i pasurive**

	Shenim	2013	Vlera neto në 2012	vlera neto në 2011
		€ '000	€ '000	€ '000
Veturat	16a.1		23	45
Pajisje të TI-se	16a.2	63	83	34
Pasuritë e tjera	16a.3	11	9	11
Pasuritë fikse të paprekshme	16a.4	10		
Totali		84	115	90

Shenim:

16a.1 Të gjitha veturat zyrtare në vitin 2013 kanë vlerë neto zero. Megjithatë të gjitha janë në përdorim nga zyra jonë.

16a.2 Furnizimi me skaner paraqet blerje të re të bëra në vitin 2013 në vlerë prej 5,420€ në këtë kategori të pajisjeve. Diferenca tjetër paraqet vlerën e zhvlerësuar.

16a.3 Në këtë kategori në vitin 2013 janë regjistruar katër (4) kamera në vlerë prej 4,080€ dhe tre (3) kabine të metalike në vlerë prej 4,170€. Diferenca tjetër paraqet vlerën e zhvlerësuar.

16a.4 Softueri për zhvillim të intranetit (që është investim në vjëm) and softueri për dizajnim të raporteve prezantoni blerjet e bëra për vitin 2013 në vlerë prej €10,491.

16.b) Përmbledhje e pasurive jo-financiare (me vlerë nën 1000€) në posedim të organizatës

	Shenim	2013	Vlera neto në 2012	Vlera historike në 2011
		€ '000	€ '000	€ '000
Pasuria nën 1000€		101	115	343
Totali	16b.1	101	115	343

Shenim:

16b.1 Blerjet e reja në vitin 2013 arrijnë vlerën 6,802€. Vlera neto e pasurisë së dhënë si donacioni shkollës fillore "Hilmi Rakovica" është 809€. Diferenca mes viteve 2013 dhe 2012 paraqet vlerën e zhvlerësimit.

16.c) Përmbledhje e stoqeve në fund të periudhës

Klasifikimi i pasurive	Shenim	Vlera historike 2013	Vlera historike 2012	Vlera historike 2011
		€ '000	€ '000	€ '000
Material shpenzues		15	13	7
Derivate për ngrohjen qendrore dhe gjenerator		5	5	9
Totali		20	18	16

Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale e buxhetit

Kategoria e ndarjes	Shenim	Përshatjet e Autorizuara nga LMFP					Ndarjet finale të buxhetit SIMFK	Ndryshimet e buxhetit fillestar
		Ndarja Fillestare Buxhetore (ligji i buxhetit)	Ndryshimi sipas nenit 30, Ligji nr.03/L-048	Ndryshimi sipas nenit 29, Ligji nr.03/L-048	Ndryshimi për të hyrat vetanake	Ndryshimet për grantet e përcaktuara të donatorëve		
		€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000		
		a	b	c	e	f	(f-a)/f	
Hyjet								
Granti qeveritar	18.1	2,120	2,120	2,070		2,070	-2.4%	
Të hyrat vetanake	18.2				7		0.0%	
Grantet e përcaktuara të donatorëve	18.3					51		
		2,120	2,120	2,070		51	0.0%	
Dajet(buxheti)								
Pagat dhe medijtjet		1,305	1,305	1,285		1,285	-1.6%	
Mallrat dhe shërbimet	10.3	620	620	615		666	6.0%	
Shërbimet Komunale		45	45	45		45	0.0%	
Transferet dhe subvencionet	18.4	100	100	75		75		
Shpenzimet Kapitale		50	50	50		50	0.0%	
Tjera							0.0%	
Totali		2,120	2,120	2,070		51	0.0%	

Shenime:

18.1 Me propozim nga zyra jonë dhe me vendim të Qeverisë së Kosovës numër 11/152, aprovohet kërkesa për reduktim të ndarjes buxhetore për Institucionin tone për vitin 2013 në vlerë totale prej €50,000 dhe ato: €25,500 në kategorinë Subvencione dhe Transfere; €20,000 Paga dhe Medijtjet dhe €4,500 Mallra dhe Shërbime.

18.2 Të hyrat vetanake prezantojnë tarifën për auditim të Pasqyrave Financiare të Programit DANIDA "Promovimi i punësimit tek të rinjtë përmes biznesit dhe shkathtësive zhvillimore 2008-2012", tarifën për analizimin e pengesave administrative në implementimin e aktivitetëve të programit DANIDA nën komponentën "Përmirësimi i punësimit tek të rinjtë" me qëllim të themelimit të praktikave me të mira për përdorim të sistemeve kombëtare në Kosovë. Në të njëjtën kohë, 967.65€ paraqet tarifën e mbajtjes së sigurimit të ekzekutimit të kontratës me kompania PBC, si shkak i mos liferimit të Laptopëve të kontraktuar.

Keto mjete janë arketuar vetëm në llogarinë kryesore të Thesarit dhe të rrejtat nuk janë të përfshira në buxhetin e ZAP-it.

18.3 Shih shënimin shpjegues 4 dhe 8.

18.4 Shih shënimin shpjegues 11.

Numri i punëtorëve (Neni 19)

12

Departamenti	Nr i punetoreve ne Ligjin e buxhetit 04/L-079	Nr. Aktual i punetoreve ne fillim te vitit 2013	Nr. Aktual i punetoreve ne fund te vitit 2013
TOTALI			
Stafi (Auditorë & Mbeshtetes)	140*	149**	144***

Shenim

* Numri aktual i kufirit te punetoreve eshte 142 per shkak qe Auditori i Pergjithshem dhe Kryesuesi i Kabinetit/U.D. Drejtori i Pergjithshem jane jashte sistemit te liste-pagesave (payrollit). Pagat e tyre jane te bashke-financuara nga donatoret dhe Kosova. Grupi Menaxhues Nderkombetar (GMN) e administratori kete zgjedhje ne pajtim me marreveshjen e veçante me Qeverine.

** Numri aktual i punetoreve ne fillim te vitit ishte 149 per shkak te faktit se dhjete (10) zvendesues jane pranuar per zvendesim te stafit ne pushim te lehonise.

*** Ne fund te vitit 2013, numri i pergjithshem i punetoreve te perfshire ne listat e pagave eshte 144, nga ky numer i punetoreve, 138 prej tyre jane me kontrate te mrekull pune, ndersa 6 te tiere ne cilesine e zvendesuesit jane angazhuar per te zvendesuar stafin i cili gjendet ne pushim te lehonise. Kater auditorë te tjere jane angazhuar me kontrate per sherbime te veçanta qe sqaron diferencen mes numrit te punetoreve ne fillim te vitit dhe atij ne fund te vitit.

Raporti për veprimet e ndërmarra dhe të propozuara për gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të pavarur (Neni 20)

PVF-te te ZAP per vitin 2013 jane audituar nga kompania private e auditimit BDO (emeruar nga Kuvendi). Eshte dhene opinionin i pakualifikuar. Ne letren e menaxhmentit jane dhene rekomandime ne lidhje me disa mangesi te MFK-se:

Nr.	Rekomandimi ose gjetja	Veprimi i ndermarre ose i propozuar	Afati i Zbatimit	Efekti
1	Ne planin e menaxhimit te kontratave duhet te perfshihet i tere stafi i cili eshte percaktuar per realizim te kontrates.	Percaktimi i vendit te nenshkrimit per secilin zyrtar nenshkrues.	E kryer	Trajtim me i mire administrativ
2	Perzgjedhja e procedurave me te pershtatshme dhe ekonomike per autoritetin kontraktues kur planifikon te shperblej me disa kontrata te ngjashme (procesi per marjen me qira te fotokopjeve).	Sektori i prokurimit ka nenshkruar nje kontrate korrize me nje OE i cili do te ofroj keto sherbime fotokopjese per stafin e ZAP per nje peridudhe prej 36 muajsh.	E kryer	Trajtim me i mire administrativ dhe sherbim me i mire.
3	Harmonizimi i regjistrimit te pasurive mbi 1,000 Euro ndermjet Regjistrit te pasurise dhe regjistrimit kontabel SIMFK.	Eshte bere harmonizimi me rastin e regjistrimit te kater kamerave ne sistemin e Free Balance-it (SIMFK).	E kryer	Trajtim me i mire administrativ
4	Gabime ne kategorizimin e pasurive dhe zbatimin e normave te zhvleresimit dhe amortizimit sipas jetegjatesise.	Kuvendi ka formuar grupin punues per adresim te mangesive ne mes te UA 21/2009 dhe sistemit kontabel ne SIMFK. Zyra jone ka rot keshillues tek ky grup. Nje Udhëzimit Administrativ eshte ne procesin e miratimit.	E kryer	Date e hershme per te thene diçka per efektin
5	Mungesa e nenskrimeve ne dy raste ne format standarde te raportit te pranimit te mallrave dhe sherbimeve nga zyrtari autorizues.	Rritje e kontrollit.	E kryer	Trajtim me i mire administrativ

SHTOJCA 3: OPINIONI I AUDITORIT TË JASHTËM PËR VITIN 2013

Deloitte.

Deloitte Kosova sh.p.k.
Rr. Ali Hadrri, p.n.,
10000 Prishtinë
Kosovë

Tel: +381 38 245 582/3
Fax: +381 38 245 584
www.deloitte.com

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Auditorit të Përgjithshëm

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, të Republikës së Kosovës (më tej referuar si "Organizata" ose "ZAP"), që përfshinë Pasqyrën Pranimit të Ardhurave dhe Pagesave, Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2013, si dhe një përmbledhje të politikave kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përpilimin dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave financiare në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligjin Nr. 04/L-194 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i ndryshuar dhe plotësuar nga ligjet Nr. 03/L-221 dhe Nr. 04/L-116, të cilët përcaktojnë që pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik - Raportimi Financiar sipas Bazës së Kontabilitetit me Para të Gatshme. Kjo përgjegjësi përfshin: dizajnimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e kontrolleve të brendshme që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; duke zgjedhur dhe zbatuar politika përkatëse të kontabilitetit; dhe duke bërë vlerësime kontabël që janë të arsyeshme në rrethanat përkatëse.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion për pasqyrat financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike si dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të arritur siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale. Auditimi përfshinë përmbushjen e procedurave për të fituar dëshmi të auditimit për shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga vlerësimet e auditorit, përfshirë vlerësimet e rrezikut të gabimeve materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në arritjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori merr parasysh kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të përcaktoj procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne i kemi përdorur janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see <http://www.deloitte.com/about> for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Member of Deloitte Touche Tohmatsu Limited

Deloitte.

Opinion

Sipas opinionit tonë, Pasqyra e Pranimit të Parave dhe Pagesave dhe Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2013, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik – Raportimi Financiar sipas Bazës së Kontabilitetit me Para të Gatshme.

Çështje tjera

Pasqyrat financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2012 janë audituar nga auditorë të tjerë, të cilët kanë shprehur një opinion të pakualifikuar mbi këto pasqyra financiare me datë 16 prill 2013.



Prishtinë, Kosovë
5 maj 2014
